



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 25 (827880)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 qershor 2024

Miratohet rritja e pagave për ushtarakët, ministri Peleshi: Jemi duke kaluar vendet e rajonit



» faqe 2

Akademia e Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Universitetin “Luarasi” dhe “Tirana Business University”, organizuan Konferencën Shkencore me temë: “Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”. Kjo konferencë vjen në një moment të rëndësishëm për sa i përket sfidave që po hasen në mjedisin e sigurisë dhe mbrojtjes.

Në përshëndetjen e tij të veçantë në këtë konferencë, SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi falënderoi pjesëmarrësit, u shpreh ndër të tjera: “Studimet ushtarake në përgjithësi dhe kërkimi shkencor në veçanti, kanë qenë prezent dhe bashkudhëtarë të çështjeve të teorisë ushtarake e doktrinare, si dhe të aplikimit të teknologjisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në gjithë rrugëtimin e saj. Studimet dhe kërkimet në fushën e sigurisë mundësojnë analizën e mjedisit dhe statusin e gjendjes aktuale të sigurisë, si një pikënisje për të nxjerrë në pah statusin e saj të kontestuar disiplinor. Mbi këtë bazë, bëhet lidhja e ngushtë ndërmjet historisë konceptuale të sigurisë me zhvillimin konkret dhe parashikimeve të saj për të ardhmen.”

Më tej, gjatë përshëndetjes së tij gjeneral Kingji, duke e konsideruar këtë konferencë shumë aktuale në mjedisin e tanishëm të sigurisë, mjedis i cili vazhdimisht ndryshon dhe është i paparashikueshëm, theksoi se kjo konferencë do të ofrojë përjasje dhe rrugë efektive drejt përmirësimit të programeve studimore, zhvillimit dhe inovacionit të edukimit ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, në funksion të ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikueshme në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. “Në këtë mjedis global të përqësuar të sigurisë, Aleanca ka përfunduar konceptin e saj të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe vënë në funksion plane të reja rajonale të mbrojtjes dhe një model të ri të Forcës së NATO-s. Nëpërmjet këtyre planeve gjithëpërfshirëse, të harmonizuara me planet kombëtare të vendeve aleate, do të bëhet e mundur mbrojtja e integritetit territorial të Aleancës dhe adresimi i kërcënimeve të identifikuara në konceptin strategjik të saj, që janë Rusia dhe Terrorizmi...”, - nënvizoi gjeneral Kingji.

Në vijim të përshëndetjes së tij, gjeneral Kingji theksoi se Forcat e Armatosura të RSH-së, janë përshtatur në mënyrë të shpejtë me këto



Zhvillohet konferenca shkencore “Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”



Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për zhvillimin e programeve mësimore dhe projekteve të përbashkëta, si dhe shkëmbimin e lektorëve, theksoi se Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes e kanë prioritet transformimin dhe modernizimin e vazhdueshëm, të gjithanshëm, gjithëpërfshirës dhe progresiv të sistemit të Arsimit të Lartë Ushtarak (ALU), në pikëpamje të modernizimit, zhvillimit të kurrikulave, programeve të studimit, infrastrukturës dhe stafit akademik.

Konferenca Shkencore “Sfidat e Arsimit të Lartë në një mjedis që ndryshon”, pati si synim rritjen e vëmendjes në harmonizimin sa më të drejtë të burimeve financiare e logjistike të FA-ve për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit shkencor, përshtatjen e programeve studimore të arsimit të lartë përballë sfidave të reja në epokën digjitale.

ndryshime, dhe përveç hartimit të dokumenteve strategjike në vijim të miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, është punuar për rishikimin e

planeve kombëtare të mbrojtjes, tashmë të ndara në domene për një adresim sa më të plotë të të gjithë spektrit të kërcënimeve dhe rreziqeve.

KKSHP, vizitë në kompanitë private

Kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm vizitojnë firmën private “Everest shpk”.

Në kuadër të modulit “Puna në grup dhe komunikimi”, Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake (DUU) realizoi me kursantët e kursit të komandës dhe shtabit të përgjithshëm (KKSHP), vizitë mësimore në Kompaninë “Everest shpk”.

Gjatë takimit me drejtues të firmës, kursantët u njohën me organizimin, mjediset e punës si dhe me bashkëpunimet që kjo kompani zhvillon si shembull suksesi ekonomik nëpërmjet drejtimit dhe komunikimit eficient.

Me anë të kësaj praktike mësimore kursantët marrin njohuri mbi punën në grup, rëndësinë e komunikimit të drejtuesit me stafin dhe të anëtarëve brenda një departamenti për të rritur performancën dhe objektivat e vetë kompanisë.



QAPN, përfundon Kursi i 81-të Fillestar i Nënoficerëve

Përfundon Kursi i 81-të Fillestar i Nënoficerëve, i cili u zhvillua në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve. Në këtë kurs kursantët hedhën bazat për karrierën e nënoficerit, ofrimin e njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njehsuara me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues grupi.



Miratohet rritja e pagave për ushtarakët, ministri Peleshi: Jemi duke kaluar vendet e rajonit

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi njoftoi rritjen e re të pagave për Forcat e Armatosura dhe personelin civil të administratës publike. Në deklaratën e bërë pas mbledhjes së qeverisë, ministri Peleshi tha se kjo është një rritje domethënëse që prek të gjitha nivelet, nga ushtari I e deri te gjeneralët, ndërsa theksoi se pagat e ushtarakëve do të rriten çdo vit, deri sa të arrijnë nivelin e pagave të vendeve të Aleancës.

“Kjo rritje filloi në vitin 2022, me rritjen më të madhe të historisë të pas viteve '90 në Shqipëri, me 30% dhe është një premtim dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit deri sa ne të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës, ku bëjmë pjesë. Pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit! Jemi shumë afër, duke kaluar vendet e rajonit, duke shkuar drejt vendeve dinjitoze”, - u shpreh Ministri i Mbrojtjes.

Në deklaratën e tij, ai specifikoi edhe nivelin e rritjes që nis nga 1 korriku. “Për ushtarin IV, paga bazë do të shkojë në 71.000 lekë sipas gradës dhe viteve të shërbimit, nga 42.000 lekë në vitin 2019, pra një rritje në këto vite prej 29.000 lekësh. Të gjitha pagave që do të lexoj, iu shtohet dhe trajtimi me ushqim që jepet në formën e kompensimit ushqimor prej 16.000 lekësh.

Pra një ushtar VI nuk do të marrë 71.000 lekë, por do të marrë 87.000 lekë. Këtë duhet të dëgjojnë të gjithë të rinjtë, pasi kushdo që do të bëhet pjesë e Forcave të Armatosura e nis me një pagesë 87.000 lekë. Politika e këtij viti, e këtij vendimi është nga 7 deri në 22%, ku në ndryshim nga dy vitet e fundit, këtë vit do i japim më shumë prioritet gradave më të ulëta.

Rreshteri në vitin 2019 e ka patur pagën 48.200 lekë, me rritjen prej 30% shkoi në 62.660 lekë dhe me rritjen e sotme shkon në 80.000 lekë, duke shtuar plus 16.000 lekë të trajtimit ushqimor”, - sqaroi ministri Peleshi.

Z. Peleshi tha më tej se: “Majorit, nga 68.800 lekë, paga i shkoi në 89.440 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 107.000 lekë pa trajtimin ushqimor. Diferenca në pesë vite është 38.200 lekë. Koloneli në 2019 paguhej 110.000 lekë, shkoi në 143.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 163.500 lekë pa trajtimin ushqimor. Gjenerali e ka patur pagën 127.500 lekë në vitin 2022, shkoi në 165.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 190.000 lekë. Pra një rritje prej 62.500 lekësh”, - theksoi ministri Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi theksoi se qeveria ka rritur buxhetin e Ministrisë



së Mbrojtjes në 2% të GDP-së, duke e bërë Shqipërinë një nga 22 vendet aleate në NATO, që përmbushin angazhimin e Aleancës. Dhe sipas z. Peleshi, në buxhetin e pagave lëvizën 11 milion dollarë, duke patur parasysh që edhe personeli civil do të ketë rritjen e pagave.

Ministri i Mbrojtjes bëri të ditur se rritje pagash do të ketë edhe personeli zjarrfikës, i cili sipas tij bën një punë shumë të rëndësishme, të pazëvendësueshme dhe të çmuar. Kjo rritje, sipas tij shkon deri në 30% në varësi të gradave: “Asistent zjarri, që është grada më e ulët e zjarrfikësit, paga aktuale është 46.000 lekë, rritet

në përqindje 30.43%, në vlerë 14.000 lekë, paga sot shkon në 60.000 lekë. Sapo hyn në Shërbimin Zjarrfikës, paga fillestare nga sot do të jetë 60.000 lekë. Zjarrfikësi, një gradë më e lartë, ka pasur pagën 52.500 lekë, sot shkon në 65.000 lekë; kryezjarrfikës nga 55.000 lekë shkon në 70.000 lekë; kryeinspektor zjarrfikës nga 74.500 lekë shkon në 85.000 lekë; inspektor zjarrfikës nga 64.200 lekë shkon në 75.000 lekë; komisar zjarrfikës nga 97.500 lekë shkon në 105.000 lekë; drejtues zjarrfikës nga 108.000 lekë shkon në 115.000 lekë; drejtues i parë zjarrfikës nga 120.000 lekë në 140.000 lekë dhe drejtues i lartë

zjarrfikës nga 131.000 lekë shkon në 160.000 lekë”, - specifikoi ministri Peleshi, duke i cilësuar si nivele shumë dinjitoze pagash. Ministri Peleshi pati edhe një thirrje për drejtuesit vendorë, në një kohë që temperaturat janë rritur dhe rrezikshmëria për rënien e zjarreve është më e lartë: “Jemi për fat të keq në prag të sezonit të zjarreve, vera e nxehtë sjell dhe qindra vatra zjarresh. Ju bëj thirrje kryetarëve të bashkive, natyrisht edhe një apel të gjithë forcës tonë zjarrfikëse, të qëndrojnë në krye të detyrës për eliminimin e pasojave, në një stinë që fatkeqësisht pritët të jetë më e nxehtë se vitet e tjera”, - u shpreh z. Peleshi.



Në ambientet e Auditoriumit, me studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe stafin akademik u zhvillua leksion nga kolonel Pietro Mostardi, Atasheu Ushtarak i BE-së për Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Qëllimi i këtij leksioni ishte: Dhënia e informacionit gjithëpërfshirës mbi Komitetin Ushtarak të Bashkimit Europian (European Union Military Committee (EUMC)).

Gjatë prezantimit studentët u njohën në mënyrë të detajuar mbi misionin, përgjegjësitë, strukturën organizative dhe strukturat vartëse të këtij komiteti, si dhe misionet dhe projektet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vëmendje e veçantë iu kushtua koordinimit dhe bashkëpunimit midis strukturave të këtij komiteti me vendet e rajonit, si dhe komandat e operacioneve të NATO-s në rajon.





Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti drejtorin e Planifikimit, Politikave, Strategjive dhe Kapaciteteve të SHBA-së për Europën, gjeneralmajor Daniel Lasica

Në kuadër të bashkëpunimit Ushtarak me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Komandën e Forcës Tokësore zhvilloi një vizitë pune Drejtori i Planifikimit, Politikave Strategjive dhe Kapaciteteve të Komandës Amerikane për Evropën, gjeneralmajor Daniel LASICA.

Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me ecurinë e zhvillimit të kapaciteteve të Forcës Tokësore, identifikimin e mundësive të reja për bashkëpunim, inspektimi i donacioneve amerikane në Shqipëri dhe takimi me skuadrën e SFAB që operon në vendin tonë.

Në vazhdim të vizitës së tij, gjeneralmajor Lasica u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Gjatë takimit komandanti FT-së prezantoi

një panoramë të përgjithshme të strukturës së Forcës Tokësore dhe Objektivave të Kapaciteteve që ajo është përgjegjëse. Më tej midis dy ekipeve u diskutua mbi procesin e modernizimit dhe sfidat që FT ka ndeshur për realizimin e këtij procesi, mbështetja nga zyra e bashkëpunimit ushtarak amerikan (ODC) nëpërmjet programeve FMSFMM; projekti i raketave kundërtanke "Javelin" dhe atyre kundërajrore "Stinger" dhe përfshija në prokurim e NSPA-së me qëllim përsheptimin e procedurave për prokurim; gjithashtu mbi certifikimin e GBKL dhe adresimi i mangësive të nxjerra nga takimi dypalësh Shqipëri - NATO për rishikimin e Kapaciteteve të Planifikimit të Mbrojtjes (DPCR 2023).

Komanda Mbështetëse dhe strukturat e saj, në mbështetje të stërvitjes së SHP "Përpjekja e Përbashkët-24"

Në stërvitjen 3-shkallëshe të FA-së "Përpjekja e Përbashkët-24", Komanda Mbështetëse është angazhuar së bashku me strukturat vartëse për mbështetjen me kapacitete dhe shërbime logjistike sipas klasave të furnizimit të FBOD dhe trupave pjesëmarrëse në stërvitje në zonën e operacionit Bizë dhe vend-dislokimin Rrapi i Treshit. Kjo stërvitje synon të testojë kapacitetet e mbështetjes logjistike me furnizim, kapacitete EOD, kapacitete xheniere, transport trupash, mjete, teknikë dhe ngritja e setit fushor. Pas përfundimit të fazës planëzuese ka filluar mbështetjen e operacionit "Stuhia 24", duke vendosur në dispozicion të Forcës Tokësore personel, mjete dhe pajisje si dhe duke ngritur setet fushore në të dyja rajonet e stërvitjes.

Efektivët e grup-batalionit gjatë lëvizjes për në rajonin e zhvillimit të operacionit, u përballën me dy incidente, të cilat kërkuar ndërhyrjen e specializuar të efektivëve të togës EOD. Duke përdorur me përpikëri teknikat dhe procedurat e parashikuara në manualin EOD ML 400-5-2, ekspertët EOD asgjësuan municionet e paplasura në rrugëkalimin e lëvizjes dhe



kryen kontrollin e një automjeti për prezencë mjeti shpërthyes, duke përdorur pajisjet dhe teknikat moderne EOD. Komanda Mbështetëse vazhdon monitorimin dhe ndjekjen e aktivitetit operacional.

Fillon stërvitja 3-shkallëshe "Përpjekje e Përbashkët 2024"

Forcat e Armatosura të RSH, në periudhën 24 - 28 qershor 2024, zhvilluan stërvitjen 3-shkallëshe të koduar "Përpjekje e Përbashkët 2024". Qëllimi i kësaj stërvitjeje është testimi i ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit të kapaciteteve ushtarake në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Stërvitja u zhvillua njëherazi në disa rajone stërvitore, nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, me pjesëmarrjen e trupave nga komandat kryesore dhe mbështetëse, institucionet arsimore ushtarake, si dhe repartet e vartësisë së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.



Operacionet EOD në ndihmë të komunitetit përmbillen me sukses

Ekipi i ekspertëve të Kompanisë EOD, në Batalionin e Xhenios, ka përfunduar detyrat për vlerësimin, heqjen dhe asgjësimin e municioneve të paplasura të identifikuara në lagjen "Jani Vruhu" në Berat dhe në fshatin Strëmbec, njësi administrative Çarçovë, bashkia Përmet. Gjatë punimeve të kryera në lagjen "Jani Vruhu", banorët e saj kanë pikasur municione të paplasura. Specialistët EOD, të angazhuar në këtë detyrë kanë bërë vlerësimin e municionit të gjetur dhe kanë konstatuar se municionet ishin granata dore mbrojtëse dhe mësymëse me ndezës të montuar. Me kujdes të veçantë ekspertët kanë bërë sigurimin e granatës mësymëse. Pas marrjes së njoftimit nga strukturat përgjegjëse, ekipi EOD ka bërë vlerësimin e municionit të gjetur në fshatin Strëmbec, njësi administrative Çarçovë, bashkia Përmet, duke konstatuar një granatë dore italiane të Luftës së Dytë Botërore, SRCM-35. Duke zbatuar masat e sigurimit teknik, ekipi EOD bëri transportimin dhe magazinimin e municioneve në mjediset e Batalionit të Xhenios.



Kompania EOD kryen punime për përmirësimin e infrastrukturës në Bazën Ajrore Gjadër

Një ekip prej 7 specialistësh EOD të batalionit të xhenios, prej më se tre javësh është angazhuar në operacion për kontrollin dhe pastrimin e sipërfaqes nga municionet e paplasura në zonën ushtarake, baza Ajrore Gjadër, Lezhë, ku po kryhen punime për përmirësimin e infrastrukturës. Gjatë punimeve në bazën Ajrore Gjadër është gjetur një municion, i cili pas vlerësimit dhe identifikimit të kryer nga ekipi EOD, rezultoi 1(një) predhë artilerie gjysmë-blindshpuese 100mm. Ekipi EOD bëri të mundur largimin sigurt të municionit dhe transportimin e tij për magazinim, duke respektuar të gjitha masat e sigurimit teknik.

Angazhimi i FAj, në stërvitjen e SHP “Përpjekja e Përbashkët 24”

Stërvitja “Përpjekja e Përbashkët 24”, është një stërvitje 3-shkallëshe e FA-së, e cila për Faj-në, përfshin pjesë të Shtabit të Faj-së, repartet Farkë, Kuçovë dhe QKR.

Synimi i Faj-së në këtë stërvitje është testimi i kapaciteteve të fluturimit ajror (helikopterë dhe UAV), si dhe aftësi të personelit pjesëmarrës gjatë procesit të planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjes. Angazhimi dhe detyrat e Faj-së konsistojnë në mbështetjen me transport ajror (“Cougar” dhe “Black Hawk”) të trupave pjesëmarrëse në stërvitje, nga FT dhe FD.

E veçanta e kësaj stërvitjeje është vënia në funksion edhe e mjeteve pa pilot, të cilët do të bëjnë fotografim, përpunim të imazheve dhe transmetim të tyre, për t’u përdorur në interes të stërvitjes. Në bashkëpunim me koordinim me Forcën Detare, përgjatë zhvillimit të DVD të stërvitjes “Imponimi 24”, pjesë e stërvitjes “PP - 24”, e cila u zhvillua në Pashaliman, FAj realizoi mbështetjen me transportin e trupave të ROS, nga rajoni i Zall-Herrit për në Pashaliman. Njëkohësisht në



funkcion të skenarëve të stërvitjes, u realizua dhe transportimi i trupave të ROS-së, me helikopterët “Cougar”, nga rajoni i Zall-Herrit për në Bazën Ajrore Kuçovë.

Nëpërmjet avionëve pa pilot UAV TB2, u realizua shoqërim konvoi i b2k për në rajonin stërvitor në Bizë, si dhe në koordinim e bashkëpunim me ASNI u përgatitën dhe transmetuan pamje imazherie nga ana e tyre.

Baza Ajrore Taktike e NATO-s, Kuçovë, pret kursantët e KLO-së të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë

Kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në interes të programit akademik, së bashku me një pjesë të stafit të këtij institucioni, zhvilluan një vizitë mësimore në Bazën Ajrore Kuçovë.

Kursantët u pritën nga komandanti i Bazës, kolonel Adrian Kuli, si dhe nga Komandanti i Detashmentit të Avionëve pa Pilot, major Eljo Bucka. Kolonel Kuli, prezantoi për kursantët e KLO-së, një briefing mbi historikun, organizimin, misionin dhe detyrat e bazës, projektet e modernizimit dhe transformimit të saj, në një Bazë Ajrore Taktike të NATO-s.

Më tej, kursantët e KLO-së, u njohën me strukturën më të re të Forcës Ajrore, Detashmentin e Avionëve pa Pilot, me organizimin, misionin dhe detyrat e kësaj strukture. Mbas prezantimeve, ushtarakët patën një sesion pyetje përgjigje dhe diskutime me interes, kryesisht mbi projektet e modernizimit të Bazës, si dhe për teknikën



me të re të Forcës Ajrore, avionët pa pilotë dronë TB2. Kursantët e KLO-së, asistuan nga afër dhe ndoqën me vëmendje zhvillimin e fluturimeve me Dronë TB-2, si dhe fluturimet stërvitore me 2

mjete helikopterë të Bazës Ajrore Farkë, përkatësisht Helikopterin “Blackhawk” si dhe atë “Cougar”, gjatë një dite aktiviteti normal stërvitor, në infrastrukturën e Bazës Ajrore Kuçovë.



Anija P-134 “Butrinti” vijon stërvitjen “Përpjekja e Përbashkët”

Anija P-134 “Butrinti”, si pjesë e stërvitjes “Përpjekja e Përbashkët” vazhdon të kryejë detyrën për kontrollin dhe sigurinë e hapësirës detare në zonën e përgjegjësisë së saj në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Sot anija P134 “Butrinti” stimuloi skenarin MIO (verifikim dhe bordim për sigurinë detare) të një anije tregtare, e cila lundronte brenda ujërave tona territoriale.

Gjatë verifikimit u zhvilluan të gjitha procedurat sipas standardeve në zbatimin e ligjshmërisë detare.

Gjithashtu është ndjekur dhe një skenar i dytë në hapësirën detare pranë linjës së gazsjellësit TAP-it, në të cilin u konstatua një mjet lundrues tip jaht.

Anija P-134 “Butrinti” është përpjekur për të komunikuar me mjetin lundrues, pasi dyshohej se mjeti po kryente aktivitet të paligjshëm në këtë zonë.

Në momentin e afrimit nga grupi i bordingut drejt jahtit, mjeti filloi lëvizjen me shpejtësi maksimale drejt perëndimit, duke u përpjekur për t’u larguar nga ujërat tona territoriale. Anija P-134 si dhe gomonia me grupin e bordingut filluan ndjekjen, si dhe kërkuan bashkëpunim nga shteti fqinj për të bërë të mundur bllokimin e tij.

Anija P-134 vijon patrullimin në rajonin e saj të përgjegjësisë për sigurinë lundimore dhe hapësirës tonë territoriale detare.



Përfaqësues të Forcës Detare, vizitë pune në Danimarkë

Forca Detare/Roja Bregdetare, si pjesë e Organizatës Ndërkombëtare për Ndihmat në Lundrim (IALA), kanë realizuar një vizitë në Danimarkë, me delegacionin të kryesuar nga komandanti i FD/RB, kundëradmiral Adnand Agastra, me fokus kryesor projektin për ndërtimin e kapaciteteve që synon rritjen e aftësive të Republikës së Shqipërisë në fushën e shërbimeve të Ndihmës Detare në Navigacion, me mbështetjen nga Autoriteti Detar danez dhe IALA.

Admiral Agastra theksoi se ky projekt i parashikuar, do të ndihmojë në modernizimin dhe zhvillimin e Shërbimit Hidrografik të Forcës Detare/Rojës Bregdetare dhe kapaciteteve të tij për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, duke rritur sigurinë lundimore në rajon.

Projekti i ngritjes së kapaciteteve të Shërbimit Hidrografik, me ndihmën e Autoritetit Detar danez dhe IALA, është një mundësi unike dhe e vlefshme për Shqipërinë.



Në Distriktin Detar Jugor u zhvillua stërvitja detare “Imponimi-24” dhe “Grupex 24” e Forcës Detare si pjesë e stërvitjes 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët-24” me mjete dhe efektiva të Distriktit Detar Jugor, Distriktit Detar Verior, Qendra e Zhytjes, Forca Ajrore, Regjimenti i Operacioneve Speciale dhe Delta Forcë.

Në këtë stërvitje morën pjesë 13 mjete detare, dy skuadra bordimi, një helikopter “Cougar”, një dron “Bayraktar”, dhe dy skuadra speciale.

Gjatë stërvitjes u improvizuan seriale stërvitore mbi lundrimin e përbashkët, manovrim taktik, lufta asimetrike dhe mbrojtja e konvojës të grupit detar, realizimi i Operacioneve të Ndalimit Detar (MIO), Qitjet bregdetare dhe furnizim në det (RAS) gjatë zhvillimit të operacionit.



Sfidat e shefit të ri të NATO-s, Mark Rutte

Kur Mark Rutte të zhvendoset në zyrën e tij në NATO, ai padyshim nuk do të ketë një periudhë muaji mjalti. Fushata e kryeministrit holandez në largim për të qenë Sekretar i Përgjithshëm përfundoi të enjten, kur ai siguroi mbështetjen e të 32 aleatëve të NATO-s (me Rumaninë, që njoftoi mbështetjen e saj). Presidenti aktual, Jens Stoltenberg, do të japë dorëheqjen deri më 1 tetor.

Rutte, i cili ka drejtuar ekonominë e pestë më të madhe të BE-së për 14 vjet, vlerësohet gjerësisht si një ndërtues efektiv i konsensusit, duke treguar gjithashtu vendosmëri në mbështetjen e Ukrainës, duke përfshirë përpjekjet e fundit holandeze në trajnimin e pilotëve ukrainas për të fluturuar me avionë luftarakë F-16. Por edhe për një politikan me përvojë, kapitulli tjetër i karrierës politike të Rutte nuk do të jetë një shëtitje në park.

Ja cilat janë pesë sfidat kryesore me të cilat ai do të duhet të përballet.

Rikthimi i mundshëm i Donald Trump

Katër javë pasi Rutte fillon punën e tij të re, amerikanët shkojnë në votime dhe mund të rizgjedhin Donald Trump, një skeptik ndaj NATO-s.

Gjatë fushatës, Trump ka kërcënuar se do të shkurtojë ndihmën e SHBA-së për Ukrainën nëse ai kthehet në Shtëpinë e Bardhë.

Nëse ai vazhdon, kjo mund t'i japë një goditje të rëndë kredibilitetit të aleatëve të NATO-s për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet kundër Rusisë, duke pasur parasysh se SHBA-ja ka qenë deri tani donatori më i madh i ndihmës ushtarake për Kievin.

Rizgjedhja e Trump pothuajse me siguri do të prishë planin e NATO-s për të përgatitur Ukrainën për anëtarësimin e saj të ardhshëm, duke përfshirë përpjekjet për të përfunduar “perëndimorizimin” e ushtrisë fillimisht të stilit sovjetik të Ukrainës.

Vendet e NATO-s vitin e kaluar prematuan se “do të jenë në gjendje t'i bëjnë një ftesë Ukrainës për t'u bashkuar me aleancën kur aleatët të bien dakord dhe të plotësohen kushtet”.

Megjithatë, duke gjykuar karakterizimin e fundit të Trump për presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelenskyy, ky angazhim duket i lëkundshëm.

Sulmi dimëror i Putinit në Ukrainë

Sapo Rutte të hyjë në detyrë, Ukraina do ta thërrasë atë për ndihmë me afrimin e dimrit.

Gjatë muajve të fundit, Rusia ka shtuar sulmet kundër termocentraleve dhe digave të Ukrainës, infrastrukturë që kërkon muaj, nëse jo vite, për t'u riparuar plotësisht.

Libri i lojërave të Kremlinit nuk është i ri. Gjatë dimrit të parë të kohës së luftës, midis 2022 dhe 2023, rrjeti elektrik i Ukrainës u sulmua rëndë.

Çelësi, thotë shefi në largim i NATO-s, Stoltenberg, qëndron në më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore që mund të mbrojnë furnizuesit e energjisë, si dhe stafin e mirëmbajtjes që punon për riparimin e objekteve të dëmtuara.

Vendet e NATO-s po luftojnë gjithashtu për të dërguar – ose, në rastin e vendit të Rutte, për të ndërtuar – sisteme të mbrojtjes ajrore.

Por Evropa nuk ka aq shumë për të dërguar, përparimi në SHBA u vonua në Kongres dhe vendet afër Rusisë janë më pak se të gatshme të heqin dorë nga mburojat e tyre ajrore në këtë kohë të rrezikshme.

Detyrimi i anëtarëve të NATO-s për të paguar

NATO-ja këtë javë festoi një numër rekord të aleatëve që arritën objektivin prej 2 për qind të PBB-së për shpenzimet e mbrojtjes. Në të vërtetë, Holanda sapo e kaloi atë prag këtë vit pas disa vitesh dështimi, por një e treta e aleancës ende nuk po arrin në shenjë.

Rajoni ka qenë një avokat i fortë për një qasje më të ashpër ndaj Rusisë. Megjithatë, më afër terrenit të Trump, gjërat janë po aq të këqija. Kanadaja, një anëtare e NATO-s që në fillim në vitin 1949, po angazhon vetëm 1.37 për qind të PBB-së, duke regjistruar 0.1 për qind rritje që nga fillimi i luftës së Rusisë kundër Ukrainës.

Ankesat e krahut lindor

Vendet në kufi me Rusinë nuk janë tifozët më të mëdhenj të Rutte. Ata ishin të zemëruar për shpenzimet e ulëta të mbrojtjes holandeze dhe janë veçanërisht të mërzitur që roli kryesor në NATO i ka shkuar gjithmonë një vendi evropian perëndimor ose



RUTTE, KA DREJTUAR EKONOMINË E PESTË MË TË MADHE TË BE-SË PËR 14 VJET, VLERËSOHET GJERËSISHT SI NJË NDËRTUES EFEKTIV I KONSENSUSIT, DUKE TREGUAR GJITHASHTU VENDOSMËRI NË MBËSHTETJEN E UKRAINËS, DUKE PËRFSHIRË PËRPJEKJET E FUNDIT HOLANDEZE NË TRAJNIMIN E PILOTËVE UKRAINAS PËR TË FLUTURUAR ME AVIONË LUFTARAKË F-16.

verior, edhe pse vendet e krahut lindor kanë qenë në aleancë për një çerek shekulli.

Kryeministria e Estonisë Kaja Kallas nuk hyri në garën për postin e lartë të NATO-s pasi iu komunikua se nuk do të merrte mbështetjen e vendeve të tilla si SHBA-të, Franca dhe Gjermania (ajo tani është kandidatja kryesore për të qenë shefja e ardhshme e politikës së jashtme të BE-së). Ata kishin frikë se emërimi i saj do të shihej nga Moska si një përshkallëzim i armiqësive.

Presidenti i Rumanisë Klaus Iohannis, i cili kandidoi për këtë detyrë, mori vetëm mbështetjen e Hungarisë, vetëm për arsye taktike, për ta mbështetur atë.

Vendet e krahut lindor tani ka të ngjarë të kërkojnë përfaqësim më të mirë në nivelin dytësor të NATO-s: zëvendëssekretarin e përgjithshëm (DSG) dhe postet e ndryshme të ndihmës sekretarit të përgjithshëm (ASG).

Shpërndarja e vendeve të punës ka qenë një pikë e dhimbshme për vendet lindore për disa kohë. Ndërsa DSG që po largohet është

rumun, të shtatë ASG-të janë nga Perëndimi dy nga SHBA, nga një nga Gjermania, Holanda, Britania, Italia dhe Franca. Një tjetër vend pune në ASG është vakant.

Në të vërtetë, një nga detyrat e para të Rutte si shef i NATO-s do të ishte të emëronte një zëvendës.

Nuk është vetëm Trump që Rutte duhet të bindë për ta mbajtur NATO-n gjallë dhe mirë. Në të gjithë Evropën, partitë e së djathtës ekstreme skeptike ndaj NATO-s dhe Putin-dashëse po lulëzojnë.

Franca, për shembull, është në prag të zgjedhjeve parlamentare që mund të shohë fitime të mëdha për Tubimin Kombëtar të ekstremit të djathtë, duke e detyruar Stoltenberg të bëjë një lutje të rrallë për Francën që “ta mbajë NATO-n të fortë”.

Rutte, natyrisht, e di shumë mirë këtë histori. Në një farë mënyre, ai filloi të konsideronte detyrën kryesore të NATO-s, kur u bë e qartë se Partia e tij Popullore për Liri dhe Demokraci e qendrës së djathtë do të humbiste zgjedhjet holandeze ndaj Partisë së ekstremit të djathtë për Lirinë e Geert Wilders, gjë që ndodhi.



**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n**

Në kapacitetin e ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-n, kam ndjekur me interes të shtuar rreth 850 ditë/netët e fushëbetejës së përgjakshme të Rusisë – Putiniste ndaj Ukrainës si dhe interesave të Aleancës Euroatlantike dhe vlerave perëndimore. Në të njëjtën kohë kam publikuar 10-ra vlerësime strategjike si dhe i kam ndarë ato me kolegë/personalitet të sigurisë të Këshillit të Atlantikut dhe Institutit të Luftës në Uashington; Qendrën Marshall, Gjermani; Bruksel, Kolegjin e NATO-s, Romë, etj.

Pa pretenduar kurrësi të “privatizoj të vërtetën shteruese” kam refuzuar me vetëdije të bëhem pjesë e “revanisë konspiracioniste”, pasi nuk kam kohë të shpërdoroj me mjerimin e kuvendarëve të emëruar, dalldisjet e analistëve të gjithë-ditur dhe sekserëve të vetë (de)graduuar Gjeneralë, që turfullojnë nëpër banaqe mediatike për skenarë ogurzi, avionë, tanke, raketa; “pronarin e çelësit të valixhes atomike, për ditën e qametit”, duke e trajtuar kështu, “luftën jo vetëm për Ukrainën” me rrethanat e Luftës II Botërore; të Luftës së Ftohtë apo fushatave kriminale të Bolshevikëve, Nazistëve, Stalinistëve, Putinistëve, etj.

28 muaj pas nisjes së fushatës ushtarake të Kremlinit ndaj sovranitetit të Ukrainës, më duhet të ri-sjell në vetëdijen strategjike si dhe atë publike njëherësh, se udhëheqës të deformuar nga paranojat e përjetësisë së (mbi) pushtetit, nostalgjikë të “lavdisë së ushtrisë së kuqe”; politikanë mëndje ndryshkur dhe kamikazë anti-perëndimor/USA, në Kremlin, Teheran, Phenian, Beograd, e gjetkë, ose “fërkojnë duart”, ose vijojnë të mbivlerësojnë fuqinë ushtarake të Rusisë me peshoren tradicionale (numër mercenarësh, tankesh; Mig/29, raketa, armë bërthamore etj.), si dhe me fuqinë e helmit të propagandës bolshevike.

Gjithsesi, në respekt të opinionit mbarëkombëtar, Rajonal, NATO-s, etj., si dhe këdo të frymëzuar apo të frikësuar nga “hija e rëndë e Kremlinit”, që parashikuan skenarin më të zi: “maksimumi 3-4 muaj, (9 maj-22) Rusia do ta celebronte me valle në Kiev fitoren e lavdishme të pushtimit të Ukrainës si dhe triumfin ndaj Aleancës Euroatlantike”, më duhet “t’i qetësoj” me 6 mesazhe gjeostrategjike:

Pikëshepëri, në dhjetëra opinione, jam përpjekur të ndaj këndvështrime, por edhe të përcjell mesazhe euro-atlantike, sigurisht dhe optimiste. Thënë këtë: kurrësi nuk e kam menduar, as shkruar, që përballja me një superfuqi të pushtuar nga oscilacionet staliniste, do ishte e lehtë, as që Rusia do gjunjëzohej për 24 orë apo 14 muaj. Në të kundërt, që në krye të herës si dhe në vijim kam përsëritur se: “do të jetë një luftë e përgjakshme, relativisht e gjatë, por që do ta rraskapitë dhe gjunjëzojë Rusinë – Putiniste. Por sigurisht Luftën do ta fitojë Ukraina martire dhe vendosmëria e Perëndimit”.

Dhe ja ku jemi, mbas 850 ditë/net luftime. Falë sakrificave dhe rezistencës sublime të Ukrainës, falë mbështetjes së fuqishme dhe të pakushtëzuar të Aleancës Euro-Atlantike si dhe përtej prapagandës dëshpëruese të Kremlinit, Rusia-Putiniste, mbasi në 28 muaj ka dështuar për të arritur objektivin strategjik: “pushtimin e Ukrainës”, po përpëllitet dhe rrakulliset drejt humbjes turpëruese të Luftës.

Mbas 28 muaj luftime: Kremlini ka humbur iniciativën strategjike të luftës. E vërtetë, ka disa përparime të sforcuara në rrafshin taktik dhe po bën gjithçka të ri-marrë epërsinë operacionale në fushëbetejë. Por, pavarësisht bombardimeve si shtet terrorist ndaj popullsisë civile, spitaleve, shkollave, hidrocentraleve, tubacionit ndërkombëtar të amoniakut; avantazheve nga mbrojtja në transhe për të penguar kundërofensivën e Ukrainës, Rusia ka humbur mbi 50 % të territoreve të pushuara; mbi 500 mijë të vrarë dhe plagosur; më shumë se 11 trilionë euro shpenzime për luftën, (ose 6 vjet të GDP-së neto), duke rrënuar kështu moralin e ushtrisë si dhe kombit rus rreth luftës!

Ndërsa për borizanët e suksesit ekonomik gjatë luftës në Ukrainë, referuar Bankës Botërore konfirmohet se: “në listën e GDP-së për 2023, Rusia është e rreshtuar e 11-ta me 1, 860 trilionë \$, 14 herë më pak se USA (26,954); shumë mbas Gjermanisë (4,430), Francës (3,052), Italisë (2,190), etj.

Së dyti: Pse Rusia ka dështuar për të sfiduar fuqinë ushtarake, kufijtë dhe interesat e Aleancës Euro-Atlantike? Pse lufta e ka forcuar përtej çdo pritshmërie solidaritetin për mbështetjen e Ukrainës si dhe kohezionin mes 32 vendeve të NATO-s?

Për shkak të kësaj lufte neonaziste, është konfirmuar anëtarësimin de-jure i Ukrainës në BE, ndërsa me Finlandën dhe Suedinë, NATO u zgjerua me 2-fishin që trashëgoi nga Lufta e Ftohtë (16/32). Po ashtu nga vetëm 5 vende para luftës (02/2022), sot 23 prej tyre (përfshi RSH) kanë arritur 2 % të GDP-së për buxhetin e mbrojtjes. Statusi Ukrainës në Samitin e Vilnius (para 1 viti), u ri-formalizua në nivelin e “Komitetit NATO – Ukrainë”, pra edhe më afër derës së anëtarësimit. Në më pak se 1 muaj para Samitit të Uashingtonit, Sekretari Stoltenberg, konfirmoi se: “bashkë me fitoren e luftës, Ukraina do të jetë vendi 33 i Aleancës”.

Pra 850 ditë luftime të përgjakshme vërtetuan (me 2-3

Pse Putini do/po gjunjëzohet nga Perëndimi dhe Ukraina?



përrashtime nga aktorë kontrovers), se Rusia-Putiniste i ka humbur edhe shpresat për të minuar kohezionin mes NATO-s dhe BE-së, duke përdorur “gazin si armë gjeopolitike” apo duke kërcënuar (si shtet terrorist) me fuqinë bërthamore.

Miratimi i paketës shtesë (250 miliardë) nga Senatit i SHBA-së dhe 55 miliardë euro nga BE; ndërsa në takimin e G-7 për Ukrainën, u vendos përdorimi i aseteve (+1 miliard euro) nga sanksionet e Rusisë për armatosjen e Ukrainës, etj. Kjo vendosmëri do të konfirmohet edhe në Samitin Uashingtonit (9-11 korrik 2024) si prova të forta se për Aleancën Euroatlantike (SHBA/NATO/BE): nuk ka asnjë opsion tjetër përveçse fitores me çdo çmim të luftës!

Në planin e mbështetjes ushtarake, në terren kanë mbërritur paketa e zgjeruar e armatimeve të gjeneratës së fundit nga SHBA, MB, Gjermania dhe pothuaj të gjitha vendet e NATO-s (tanke “Abrams”, “Challenger”, “Leopard”, sistemeve “Patriot”, dronë, avion F-16, helikopter luftimi, municione artilerie, etj.), që janë garanci e mbështetjes deri në fitoren e Ukrainës me të keqen e përbashkët (Rusisë – Putiniste).

Shtojmë, se kërcënimin delikuent i Putinit që Rusia do sulmojë çdo vend që armatos Ukrainën (duke nënkuptuar, SHBA-të, MB-në, Gjermaninë, Poloninë, etj.), ndërkohë që është e provuar botërisht që vetë Rusia – Putiniste po furnizon me armë shtetet dhe grupet terroriste: këtë deklaratë e gjej edhe më cinike se e gjithë ndërmarrja e tij kriminale. Përgjigjen më herët e ka marrë nga SHBA-të, MB, Gjermania, etj., ndërsa së fundi përgjigjen e fuqisë së forcës ushtarake e mori edhe nga Franca zyrtare, me propozimin për ndërhyrjen edhe me trupa në Ukrainë. Kjo vendosmëri e imponoi Putinin për të bërë “dhelpren”, pra nga kërcënimet te oferta për “marrëveshje për paqen”, d.m.th. të nënshtrimit të Ukrainës dhe Perëndimit për status quo-në e territoreve të pushtuara, përfshi Krimenë. Marrëveshje, që jo vetëm askush nuk do ta pranojë, por as Lavrovi i Tij nuk do e besonte si ofertë për paqe të qëndrueshme!

Sa për pasojat fatale në rast përdorimi të armëve bërthamore (Rusia, 5977 njësi kundrejt 5428 SHBA; 290 Franca; 225 UK) me të cilat Putini kërcënon se “do t’i bëjë gjëmën qytetërimin”, përgjigja e perëndimit mbetet e ftohtë: “nëse vetëm do të guxonte”, Rusia jo vetëm do të damkosej përjetësisht si “shtet terrorist” por edhe do të ndëshkohej/t në mënyrë shembullore nga fuqia e pamposhtur e SHBA/NATO/MB, ndërsa Putinistët do dënoheshin si nazistët: për krime kundër njerëzimit!

Së treti, Kremlini është vetë-demaskuar në luftën për të tronditur rendin e sigurisë globale. Që në krye të herës, (por edhe në mbi 28 muaj luftime) u konfirmua se agresioni ushtarak, nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë, kufijve të demokracisë, si dhe ndaj interesave dhe vlerave Trans-atlantike (SHBA/UN/NATO/BE)!

Prandaj, pas 28 muaj luftimesh, Rusia - Putiniste gjendet edhe më e izoluar por dhe më e diskredituar se asnjëherë më parë në historinë e saj gjeopolitike. Për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimmarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB, ndërsa nga Gjykata Ndërkombëtare është lëshuar “urdhër arresti për krime lufte” ndaj Putinit si dhe për listën e Gjeneralëve dhe zullumqarëve rreth tij; nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 4 shtete terroriste e njohën këtë aventurë neo-naziste; është përjashtuar nga Samitet G-8/7 (me miratimin edhe të Kinës...), nga Kampionati i Futbollit (Euro-2024), si dhe i janë ngrirë mbi 200 miliardë euro asete për shkak të sanksioneve ndaj Rusisë.

Vetëm për shkak të kësaj lufte-neonaziste, Putinit refuzojnë t’i japin dorën edhe autokratët e Azisë Juglindore. Për më qartë, ndërsa

Putini pritët në bunkerin e Kim Jong-ut, në të kundërt, Presidenti Zelenski pritët “si hero” nga të gjitha kancelaritë dhe kryeqytetet e aleancës euroatlantike si dhe botës së qytetëruar.

Së katërti: me gjithë jargavitjen dëshpëruese dhe ndihmave të kufizuara në industrinë ushtarake, Rusia ka mbetur e “keq-zhënjyer”, për të tërhequr Pekinin në një aventurë gjeostrategjike, duke përfshirë Kinën në një front lufte ndaj Tajvanit. Në të kundërt, që në fillim të kësaj ndërmarrje kriminale, me qetësinë Aziatike, Pekini paralajmëroi Moskën për mos-vendosjen e armëve bërthamore në Bjellorusi.

Kanë dështuar edhe llogaritë e pinjollit të KGB-së si dhe “diplomatët dhe gjeneralët e lemerisur” nga Putini, të cilët nga “deliri i fitores së padiskutueshme” as nuk e kishin konsideruan që, kur vjen fjala për interesa gjeopolitike, Kina nuk mund të jetë kurrësi aleate e natyrshme me Rusinë në luftën kundër SHBA-së dhe BE-së”.

Së pesti: me gjithë perden e hekurt dixhitale, putinistët e kanë humbur edhe betejën për të mbajtur gjallë kohezionin e kombit Rus. Në të kundërt, mbi 500 mijë të vrarë dhe plagosur në fushëbetejë; më shumë se 11 trilionë \$ kosto në 850 ditë/natë lufte, ose mbi 5 herë më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm vjetor neto i Rusisë (2023 = 1, 860 trilionë \$); etj., e kanë leqenditur moralin e ushtrisë, epërsinë strategjike, peshën gjeopolitike dhe bashkë me këto edhe krenarinë dhe kohezionin e kombit Rus.

Ndoshta për “meritë të armës bolshevike të dezinformimit” krijuan një mjegullnajë rreth shpërdorimit (si limon i shtrydhur) të mercenarit të salsiçeve (Progozhin) dhe Dodikut në Ballkan, si ndër përpjekjet për të rikuperuar kohezionin, ndërsa Moska i ka mbështetur shpresat te rekrutimi mijëra mercenare/fukarenj (që luftojnë për para dhe jo për Rusinë) për të mbajtur dhe avancuar vijën e frontit në fushëbetejë.

Së gjashti: Rusia – Putiniste, fatmirësisht ka humbur edhe betejën për të ndezur një front lufte, duke frymëzuar grupet kriminale, axhendën e politikanëve të korruptuar, oscilacionet e neo-Millosheviçëve në Beograd apo ekstremistët e tipit Dodik në Ballkan, duke kërcënuar “deri me agresion ushtarak” jo vetëm sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës, por edhe prezencën e KFOR-it si dhe paqen, status quo-në dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike në rajon.

E thënë edhe me gjuhën popullore, në këtë përballje të përgjakshme: “njëra vezë do të thyhet”. Prandaj nuk besoj se edhe mendjet më të ndryshkura dhe ata që hanë nga sallata/propaganda Ruse, mendojnë se: “është opsion që perëndimi ta humbasë këtë luftë për jetë a vdekje me të keqen e përbashkët”. Konsideruar këto, jam edhe më i bindur se bashkë me humbjen turpëruese të luftës neo-naziste për pushtimin e një vendi sovran, Ukrainës stoike, Rusia - Putiniste do të gjunjëzohet në përballjen edhe fuqinë e pakonkurrueshme ushtarake të USA/NATO-s, si dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike (SHBA/NATO/BE)!

Në shtesë, faktorët me peshë politike (jo vülëhumbur dhe egocentrikë të sëmurë, që premtajnë parajsa piramidale, si 50 milionë për FSK-në, toka në Mars për ish-pronarët, etj., përralla si këto që do turpëronin edhe Ali Komikun e Bagdadit) si dhe aktorët shtetërorë të Tiranës do të këshilloja që: “humbja e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar që e pret mbas lufte Rusinë (përfshi në Ballkan), mbart një rrethanë të favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit të RSH në tavolinat e vendimmarrjeve të mëdha (SHBA/NATO/UN), si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtare në Rajon, Mesdhe, etj.”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Çdo ditë dhe më tepër po shohim se si shoqëria e shekullit të 21-të lëngon nga probleme, të cilat humanët janë në tentativë të përhershme për t'i mbuluar me tisin e modernizmit, apo le të themi “ecjes me kohën”. Të jetuarit jashtë kësaj “ecjeje” konceptohet si njëfarë gjallimi kuturu mes ndjenjave hipokondrike. Që ta shmangësh ankthin, duhet të ecësh me kohën se s'bën. Substrati i brendshëm na vë përpara një problem të vjetër, të njohur tashmë nga duzinë librash, nga intelektualë disidentë që dhanë jetët për idealet e tyre progresiste.

Si mund t'i qasemi problemit në epokën tonë, kur kemi të bëjmë me absolutizëm të moderuar?

Kështu nuk mund të depërtojë dot të menduarit lirshëm, me këtë natyrisht nënkuptoj të menduarit nën një konditë që i projekton kufijtë dhe jo lirinë e pafre, ku të thuash gjithçka pa dhënë llogari dhe të arrihet diversiteti, pra, thënë ndryshe, progresi social dhe pranimi i tjetrit.

Anarkinë sociale sot e çon përpara makineria e fuqishme dhe efikase e duzinës së rrjeteve sociale dhe konsumit publik. Aty dashurohet, aty bëhet gjakimi intelektual e artistik, aty gjykohej e dënohet, krijohen kuadro, potenciale, përafrohet tjetri apo hidhet tej si i pavlerë, i diskutueshëm, i frikshëm... dhe gjithë kjo nën aparaturën famoze të “like”-ve që ka ndërtuar Facebook-u. Dhe në Facebook, nën njëfarë pseudo-paradigme të “Vdekjes së autorit e autoritetit”, bëhet barazia e gjithë njerëzve pa marrë parasysh kontributin, peshën intelektuale të mendimit etj.

Pra, nuk është qenësore nëse je profesor, shkrimtar, njeri i librave, lexues i thekur, gazetar me përvojë apo tuhaf, idiot, njeri që gjerb kafe e çaj tërë ditën qoshes së trotuarit a llafosesh, duke kthyer ndonjë gotë në mejhane, aty e ke hisen tënde, je dikush, në kuptimin që mund ta japësh kontributin në absolutizmin e fenomenit kulturor, ngjarjes, artistit a ndonjë çështjeje delikate që mëton të debatohet. Zëri yt do të dëgjohet dosido. Mjaft që t'i japësh, të shfaqesh, të flasësh, të thuash diçka që i shkon përshtat masës. Po mora mundin, ta zëmë, të publikoj në profilin tim një shkrim për të madhin e letrave shqipe Ismail Kadare, interesimi nuk do të jetë i madh, mezi do t'i arrijë 4-5 “like” (të gjitha nga njerëz që ia kanë dëgjuar emrin apo kanë sosur t'ia dëgjojnë ndonjë interpretim), pjesa tjetër veç e ka absolutizuar një çështje të tillë, është sosur kjo punë, se Kadare s'paraqet asnjë farë interesimi, është instinktivisht pasazh facebook-ian (nga qindra e mijëra të tillë) që duhen tejkualuar, përtypur në çast dhe, natyrisht, në heshtje, duke mos denjuar t'i jepet një “like”, sepse po e bëre në njëfarë mënyre i bie se je “përlyer” në këtë mesele.

Mania e “like”-ve shtrin itinerarin gjerë e gjatë dhe s'do mend që shërben si mjet efikas i absolutizmit, deri edhe i mendimit, i reagimit për diçka.

Fjala vjen, çfarëdo reagimi, shkrimi (qoftë artistik apo jo), analize politike a çfarëdo tjetër, po pati performancën e ulët të “like”-ve, s'denjon vëmendje, sepse s'e tejkalon dot kuadrin e peshës së rëndësisë dhe nxitjes. Me këtë logjikë s'është i njëjtë mendimi i dikujt që “vlen” 900-1k “like”.

Edhe ato “like” bëhen nga kortezia, apo të themi simpatia, që ka personi për ne, por jo nga interesimi i shfaqur.

Facebook-u, është një projektion i madh, që ia bën më së miri ‘punën’ ngutisë, shpejtësisë, kaosit, mosdurimit, artificialitetit, shterpësisë së mendimit e opinionit, që ndryshe përkthehet në kontribut direkt e real në absolutizmin bashkëkohor, që ngjizet me instinktin e ndjekjes së turmës, verbërisht.

Njeriu i sotëm është njëdimensional dhe po e paguan haraçin, duke u shndërruar në një konsum që bluhet pamëshirshëm.

Refleksion i ndjenjave hipokondrike



Cilat janë vlerat humane e demokratike në të cilat konsiston “pluralizmi” i sotëm?

Gjithë këto stisje në fakt degradojnë drejt inercisë të një sistemi social inert, ku mendimi dhe paraqitja vlejnë aq sa “like” dhe sa vëmendje ke. Njëri nga problemet e mëdha të aktualitetit tonë kulturor e politik është shndërrimi i njeriut në numër, rrjedhimisht në turmën që varion absolutizmin e moderuar. Që t'i arrish qëllimet, duhet t'i përveshësh mëngët, t'i nënshtrohesh turmës dhe të mendosh me kokën e tjetrit, gjersa i sakrifikon idetë autentike, mendimet e perceptimet e tua për t'u shndërruar në ulok, i gatshëm për t'u dirigjuar nga turma dhe trendi. Ta ndjekësh trendin, kjo ka shumë rëndësi, sensacionet, artistët e momentit apo personalitetet e ditës çdoherë vigjilentë dhe me kujdes të shtuar për t'u ikur gjërave që shoqëria ua ka vendosur damkën “old” (në kuptimin e vjetër, e tejshkuar, që s'bën e s'vlen më) apo “bajate/monotone” (në kuptimin e diçkaje që kërkon mund e kohë për t'u rrekur me të, pra, s'është qenësore për të humbur kohë me të tilla gjëra gjersa teknologjia përparon dhe tjetër çka është ‘in’, dhe këtu mund të përfshihet ndonjë libër që s'i flet gjë lexuesit meskin të sotëm, ndaj dhe e përçmon si bajat apo të vjetër).

Po denjove haptas ta pranosh se s'rrekesh të merresh me paçavure të tilla si ‘reality show’ apo emisione demode me qeshje të shtirura, spektakle false, monotone deri në kulm duhet ta bartësh me vete rrezikun e, le të themi, desocializmit, të shpallësh ‘oldschool’, i prapambetur, hipokrit (në kuptimin që kur je vetëm në shtëpi, nuk lë TV e reality show pa shikuar me ëndje), e të tilla damkosje të cilat mund të përkthehen mandej me humbje totale të interesit për ty dhe për atë që përfaqëson, “like”-t veniten fare, të shohin vëngër, me ngërdheshje e nënqeshje tallëse, derisa përfundimisht të shtrijnë në absolutizim, duke

të shpallur jo interesant! Në kuadrin e këtij absolutizmi veçse është vendosur skema e asaj që është kulturore dhe jo kulturore, artistike dhe jo artistike.

Në epokën tonë është ndërtuar kulti i masmedias që mbërthen shoqërinë duke e nënshtuar, kontrolluar është shndërruar në një hapësirë boshe, larg realitetit, paraqitje, shfaqje, tha ky e tha ai, ky është qëndrimi i tij e i saj, debate të panumërta për temat e njëjta, reality show krejtësisht grotesk – krijojnë konglomeratin e thashethemnajës gazetareske.

Shoqëri vizionesh të mbyllura

Shoqëria jonë bie e zgjohet me lajmet rozë. Është shoqëri e dhënë pas sensacionit. Brenda këtij absolutizmi, njerëzit bien theror për sensacion, për vëmendje, ku përmbajtja është krejt periferike dhe e padenjë për t'u zënë në gojë.

Kushdo që ka ndonjë histori për të rrëfyer apo ndonjë ide “game-changing” mund të dalë në televizion, me kusht që, ose të tërheqë vëmendjen, ose të tregojë sharlatanizmin individual të tij.

Nuk është një epokë e mirë për artin e retorikës, e di, por refleksioni im është shpirtëror...

Universiteti duhet të shkatërrohet. Në vend të tij do të festohen të gjitha llojet e mosdijes. Disiplina tërësisht të reja po lindin, të tilla si shkencat antisociale. Më zgjoni kur të ketë përfunduar, sepse e tashmja nuk më përket mua.

A do të përfundojë ndonjëherë?

A do të përfundojë ndonjëherë kjo zallamahi kulturore e sociale që e shpërfytyron njeriun, ia mohon individualitetin e mendimin kritik, e nënshtrohet për ta përdorur siç i duhet dhe e shndërron në mish për top për ta bluar. Për të mos rënë në grackën e përqeshjes kolektive, dhe harresës së pamëshirshme, duhen shmangur formulime të tilla si: “Injoranca është opium për shoqërinë! Mediokriteti kundërmon budallallëk! Rrofshin parimet e vërteta!”.

Lamtumirë, poeti, polemisti, zëri i potershëm, shpirti i temperuar në kudhrën e botës trazimtare

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Agim Doçi lindi më 9 maj 1948, në Shkodër, u arsimua në qytetin e lindjes deri në gjimnaz dhe vazhdoi më pas studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike. Punoi si inxhinier në Montimet Industriale, duke marrë pjesë në shumë objekte të rëndësishme si Fabrika çimentosh, Metalurgjik, Superfosfat Laç, Poligrafik Tiranë etj. Në fund të viteve '80 ka punuar pranë Kombinatit të Drurit "Misto Mame" si kryeinxhinier për energjinë. Në 1989 dënohet, duke u caktuar të punojë me tre turne në fabrikën e letër-kartonit. Përfshihet në lëvizjet e dhjetorit 1990.

Është autor i shumë teksteve të këngëve shqiptare, fituesi i mbi 50 çmimeve, ndër to dhe dy herë përfaqësues me tekstet e tij në Eurovizion.

Veçohet bashkëpunimi me kompozitorin Edmond Zhulali në shumë këngë të festivaleve në Shqipëri dhe me mbi 100 këngë për luftën e Kosovës.

Përmendim këngë shumë të njohura si "Marrshi i UÇK-së", "A vritet pafajësia".

Ka botuar disa libra me poezi si "Hajde dru me pre", "Rrëzuar mbi vetminë", "Rituali i kryqëzimit".

Por jeta shpesh të sjell "surpriza" të pakëndshme, nga ato që të ndalin frymëmarrjen dhe të shokojnë. Siç ishte mëngjesi i nxehtë i fund qershorit, kur mediat nisën edicionet informative me lajmin e trishtë: "Ndahet nga jeta poeti i madh Agim Doçi".

A mund të "shuhet" një poet, një shpirt "rebel" që të vërtetën ka sinonimin e tij?

Poeti iku, iku në parajsën e tij, për të lënë mes tokësorësh shumë më shumë se çfarë do të mund të marrë me vete në këtë ikje. Iku pa e përmbushur misionin e tij... Nuk iu dresht asnjë përleshjeje, siç nuk i dredhoi asnjë prite.


Luftoi me zë, me zemër e me shpirt, për të fituar, Agim Doçin dhe përjetësinë.

Dhe nuk ishte pak ajo çfarë ai arriti, çfarë ai bëri, çfarë ai desh. Ndoshta la ndonjë gjë pa përfunduar, por ato që ai bëri, i bëri si deshti, duke bërë më të mirën dhe duke u shpërblyer, jo dhe aq me lavdi dhe merita, se sa me përmbushje të shpirtit.

Na bëri të qeshnim dhe të mendonim, ta donim dhe urrenim. Ndoshta ai nuk kishte një doktrinë për të shpërndarë, por fjalën dhe qëndrimin e bëri tempull. Nuk zbriti nga Kryqi si një shenjtor, por nuk la kryq pa hipur e gozhdë pa provuar. Kishte flakë fjalën dhe zjarr qëndrimin.

Agim Doçi do të jetë përgjithmonë në kujtesën tonë, po aq sa poet dhe polemist, antikonformist dhe kontributor vlerash intelektuale. Zëri dhe mendimet e tij ishin gjithnjë të potershme, sepse vetëm kështoj do të ishte e mundur të dëgjohej intelektual i vlerave, ai që e donte me mish e me shpirt këtë vend. Erdhi dhe iku për të mbetur një fenomen poetik dhe mediatic. Agim Doçi nuk kishte një model krahasues, sepse ishte vetë identiteti i tij unik, ajo çfarë përfaqësoi dhe ngulmueshëm kërkoi të ishte aty, aty ku ai guxoi gjithnjë të ndeshet.

Po të kishte të drejtë fjale, Agim Doçi, me patjetër edhe sot do të kishte diçka për të thënë... Ndoshta do të thoshte,



● Agim Doçi do të jetë përgjithmonë në kujtesën tonë, po aq sa poet dhe polemist, antikonformist dhe kontributor vlerash intelektuale. Zëri dhe mendimet e tij ishin gjithnjë të potershme, sepse vetëm kështoj do të ishte e mundur të dëgjohej intelektual i vlerave, ai që e donte me mish e me shpirt këtë vend.

se vdekja ishte zemëruar me të më shumë se sa ata që ai la pa gjumë, apo ata që ai i futi në pështjellime njëjtë si në mendime, me fjalën e tij të urtë dhe humorin e tij pikant.

Vargjet e tij, himn i jetës në të gjitha dimensionet e saj, do të mbeten të pavdekshme.

*Kisha shumë vite që kisha vdekur
Erdhën plot njerëz dhe në varrim
Sa fjalë të bukura që kishin gjetur
I kishin shkruar mbi varrin tim...*

*Sa turp më vinte, sa më peshonte
Rrasa e varrit me ato fjalë.
Ndonëse parajsa nuk më pranonte
Ndoshta dhe shpirti s'më kishte dalë...*

*Sa isha gjallë më ndenjen frohtë
Nuk e kuptoja çfarë kisha bërë
Doja nga njerëzit një fjalë të ngrohtë
Vetëm më iku, jeta e tërë...*

*Tani që s'jam, mos u frikësoni!
Se larg prej jush vendin e gjeta.
Rri kuvendoj me Perëndinë
Ai s'paska frikë nga e vërteta!*

Kodikët e shenjtë të Beratit

Në fund të vitit 1943, një togë ushtarësh gjermanë u ngjitën në Kalanë e Beratit me qëllim përmbushjen e një misioni special. Të drejtuar nga një oficer që duket ishte edhe bizantinolog, ata kishin urdhër të gjenin dhe merrnin me vete disa libra të vjetër që i përkisnin kishës.

Të dhënat i kishin tepër të sakta. Thoshin me gojën e tyre se librat ishin shkruar me dorë në pergamenë me ngjyrë të purpurt dhe se datonin përmbi 1000 vite.

Për të shtënë në duar librat e rrallë, ushtarakët nazistë kishin dorë të lirë të kryenin edhe raprezalje, madje të shkonin në plumb të gjithë ata që do t'i pengonin në qëllimin e tyre, qofshin edhe njerëz në shërbim të Zotit.

Në fakt nazistët e dinin mirë se çfarë kërkonin në Kishat e kalasë së Beratit. Ajo që nuk dinin ishte se klerikët ortodoksë dhe banorët e lagjes Kala nuk përballeshin për herë të parë me një rrezik të tillë. Librat e vjetër, apo librat e shenjtë të Kishës, kishin qenë historikisht në shënjestër të ushtrive të huaja pushtuese.

Por çfarë ishin këta libra? Çfarë përfaqësonin për Kishën dhe shqiptarët?

I pari dhe më i rëndësishmi është i quajtur Kodeks Beratinus 1 – ose Kodiku i purpurt i Beratit, një ungjill prej 190 faqesh të shkruara me dorë mbi pergamenë, që përmban shumicën e teksteve sipas Shën Markut dhe Shën Mateut.

Libri daton në mesin e shekullit të gjashtë pas Krishtit dhe përfaqëson një nga tre apo katër ekzemplarët më të vjetër të Dhiatës së Re, duke qenë edhe një pikë e rëndësishme referimi për zhvillimin e letërsisë biblike dhe liturgjike në të gjithë botën.

Libri tjetër, Kodeks Beratinus 2, ose Kodiku i Artë i Beratit, është më i ruajtur. Daton në shekullin e nëntë pas Krishtit, përbehet nga 420 faqe dhe i përmban të plotë të katër ungjijtë. Edhe ky kodik është prej pergamene, por ka një veçanti: është i shkruar, nga fillimi në fund, vetëm me shkronja ari.

Historia thotë se gjatë Mesjetës, edhe pse nuk ishte një fakt të cilit i ishte bërë publicitet që të tejkalonte kufijtë e zonave të populluara me shqiptarë, kodikët e Beratit janë vënë në shënjestër të pothuaj të gjitha ushtrive të huaja pushtuese. Francezët, italianët, serbët osmanët e kështu me radhë, që të gjithë do të kërkonin të merrnin kodikët e Beratit, pavarësisht kostos, pavarësisht masakrave në radhët e popullsisë së këtij qyteti.

Dy kodikët e purpurt të Beratit do të bëheshin të njohur përtej trevave shqiptare vetëm në pjesën e dytë të shekullit të 19, kur një Mitropolit i Beratit, i quajtur Anthim Aleksudhi dhe më pas një studiues belg, Pjer Batifol (Pierre Batiffol), do të publikonin studime të mirëfillta shkencore për dy kodikët.

Pikërisht këto studime do të bënin që interesi dhe gjahu ndaj kodikëve të shtohet. Gjatë Luftës së Parë Botërore klerikët ortodoksë dhe populli i Beratit arrijnë t'i ruajnë ata nga ushtria austriake, ndërkohë që ruajtja e kodikëve gjatë Luftës së Dytë, nga grabitja e ushtrisë nazi-gjermane, është e mirë dokumentuar.

Kodikët murosën në dyshtet e një prej kishave të shumta të Kalasë së Beratit dhe kështu vijuan të mbeten në pronësi të shqiptarëve.

Ata dalin në dritë vetëm në vitin 1968, kur i gjallë kishte mbetur vetëm njëri nga priftërinjtë që ruante sekretin.

Përkundër një fushate të egër që kishte ndërmarrë regjimi komunist i Enver Hoxhës për shkatërrimin e objekteve fetare pas ndalimit të fesë më 1967-ën, si duket autoritetet shqiptare të kohës kishin kursyer kodikët e vjetër.

Sot, në Arkivin Qendror Shtetëror, përkatësisht në Fondin 488, ruhen 128 kodikë dhe fragmente. Ndër ta më të rëndësishmit janë dy kodikët e Beratit, Codex Purpureus Beratinus dhe Codex Aureus Anthimi.

Më i vjetri nga këta dy kodikë është Codex Purpureus Beratinus apo siç quhet ndryshe Kodiku i Parë i Purpurt i Beratit, i cili i takon shek. VI, kurse i Dytë i takon shek. IX. Rrugëtimi i Kodikëve të Beratit nis nga prodhimi pranë Konstandinopojës në periudhën e Perandorit Justinian, vijon në Berat me përpjekjen e beratasve për ta shpëtuar nga plaçkitja pushtuesve serbë në vitin 1356 e deri në luftën e Dytë Botërore.



Kodiku i Parë i Purpurt i Beratit?

Është një dorëshkrim i punuar në shek. VI pas Krishtit, diku pas vitit 533, në kohën e Perandorit Justinian, i shkruar në pergamenë, e cila është një pergamenë luksoze pasi është ngjyer me ngjyrën e kuqe perandorake ose e purpurta perandorake. Një traditë që na vjen nga Roma, ku Perandori vetëm mund të vishej me të purpurta, kurse në Bizant Perandori i vetëm ishte ai, i cili mund të përdorte ngjyrën e kuqe në dokumente apo në libra.

Cila është veçantia e tij, që e dallon nga veprat e tjera të kësaj natyre?

Libri është prodhuar me shpenzimet e Perandorit dhe me kërkesë të Perandorit. Përmban tekstin e ungjillit të Mateut dhe të Markut, i shkruar i gjithë teksti me germa të argjendta kapitale “majuske” në dy kolona nga 17 rreshta për kolonë dhe i gjithë libri ka 190 fletë. Themi libër, mund të thuhet edhe kodik, nuk ka të bëjë, ose dorëshkrim është e njëjta fjalë.

Kur u restauruan?

Duke qenë se në vendin tonë kjo gjë nuk mund të bëhej, këto dorëshkrime u dërguan për restaurim në vitin 1971, në Republikën Popullore të Kinës dhe janë kthyer në Janar të vitit 1972, në Tiranë dhe që prej asaj kohe qëndrojnë në Arkivin Qendror të Shtetit dhe kanë lëvizur vetëm në raste ekspozitash brenda apo jashtë vendit.

Kapakët prej druri, veshur me argjend të larë në ar, punuar me gdhendje dhe incizim, i janë vendosur pas një restaurimi të shek. XVIII. Janë përfunduar më 30 mars 1729 nga dora e Anastas Haxhifilipidhit në Voskopojë.

Ndërkaq, Kodiku nr.23, hirmolog (muzikë bizantine) është dorëshkrim në letër i vitit 1292, në 159 fletë, dekoret e të cilit janë punuar me bojëra uji. Është shkruar nga Mihail Slavopuli prej fshatit Krasnik. Kopje digjitale të Kodikëve të Beratit u publikuan në Librarinë Digjitale Botërore të Librarisë së Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



KODIKU I BERATIT NR. 1 (BERATINUS PURPUREUS Φ).
Dyungjillësh, dorëshkrim, greqisht, shek. VI, pergamenë e purpurt, 190 fletë, ≈ 215 x 230 mm, 2 kolona, 17 rreshta për kolonë, kopist anonim. Përmban Ungjillin sipas Mateut dhe Markut, shkruar me germa

kapitale në shkrim të vazhdueshëm (scripta continua). Për tekstin është përdorur ngjyrë argjendi në pergamenë të purpurt. Periudha e Justinianit të Madh, ndoshta pas shtypjes së revoltës Nika (532).
AQSh, Fondi: Koleksioni i Kodikëve, Dosja 1.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Më 26 qershor 2024, Këshilli i Atlantikut të Veriut vendosi të emërojë kryeministrin holandez Mark Rutte si Sekretarin e Përgjithshëm të ardhshëm të NATO-s, duke pasuar Jens Stoltenberg.

Z. Rutte do të marrë funksionet e tij si Sekretar i Përgjithshëm nga 1 tetori 2024, kur mandati i Stoltenberg përfundon pas dhjetë vjetësh në krye të Aleancës.

Jens Stoltenberg u bë Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s në tetor 2014. Si ish-kryeministër i Norvegjisë dhe i dërguar i posaçëm i OKB-së, z. Stoltenberg ka një histori të dalluar të arritjeve vendase dhe ndërkombëtare që përfshijnë sigurinë, mbrojtjen, klimën, energjinë dhe ekonominë. Ai është një mbështetës i fortë i bashkëpunimit më të madh global dhe transatlantik. Aleatët e NATO-s e kanë zgjatur mandatin e Stoltenberg me pëlqim unanim katër herë dhe mandati i tij do të përfundojë më 1 tetor 2024.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Koordinimi i proceseve të konsultimit politik

Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil ndërkombëtar i Aleancës. Ky person është përgjegjës për drejtimin e procesit të konsultimit dhe vendimmarrjes në Aleancë dhe për të siguruar zbatimin e vendimeve. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s zgjidhet me konsensus nga të gjitha vendet anëtare dhe ka tre përgjegjësi kryesore.

Së pari dhe më kryesorja, Sekretari i Përgjithshëm kryeson Këshillin e Atlantikut të Veriut, organi kryesor vendimmarrës politik i Aleancës, si dhe komitete të tjera të larta vendimmarrëse. Pra është Kryetar i Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe organeve të tjera kyçe. Këto përfshijnë Grupin e Planifikimit Bërthamor, Këshillin NATO-Ukrainë, Këshillin NATO-Rusi dhe Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik. Përveç kësaj, Sekretari i Përgjithshëm kryeson Komisionin NATO-Gjeorgji.

Mbi dhe përtej rolit të kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm ka autoritetin të propozojë çështje për diskutim dhe të përdorë shërbimet e tyre të mira në rast mosmarrëveshjesh ndërmjet shteteve anëtare. Ata veprojnë si lehtësues vendimesh, duke drejtuar dhe udhëhequr procesin e ndërtimit të konsensusit dhe vendimmarrjes në të gjithë Aleancën. Për të lehtësuar këtë proces, Sekretari i Përgjithshëm mban kontakte të drejtpërdrejta me kërret e shteteve dhe qeverive, si dhe me ministrat e Jashtëm dhe të Mbrojtjes në NATO dhe vendet partnere. Kjo përfshin vizita të rregullta në NATO dhe vendet partnere, si dhe takime dypalëshe me zyrtarë të lartë kombëtarë, kur ata vizitojnë selinë e NATO-s. Në mënyrë efektive, roli i tyre u lejon atyre të ushtrojnë njëfarë ndikimi në procesin e vendimmarrjes, duke respektuar parimin themelor se autoriteti për marrjen e vendimeve investohet vetëm në vetë qeveritë anëtare.

Së dyti Sekretari i Përgjithshëm është gjithashtu zëdhënësi kryesor i Aleancës dhe përfaqëson Aleancën në publik në emër të vendeve anëtare, duke reflektuar qëndrimet e tyre të përbashkëta për çështjet politike. Ata gjithashtu përfaqësojnë NATO-n përballë organizatave të tjera ndërkombëtare, si dhe ndaj medias dhe publikut në përgjithësi. Për këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm mban rregullisht konferenca dhe deklarata për shtyp, si dhe ligjërata dhe fjalime publike.

Së treti dhe së fundi, Sekretari i Përgjithshëm është zyrtari ekzekutiv i lartë i Shtabit Ndërkombëtar të NATO-s, përgjegjës për caktimin e stafit dhe mbikëqyrjen e punës së tij.

Mbështetja për Sekretarin e Përgjithshëm dhe procesi i përzgjedhjes

Në punën e tij të përditshme, Sekretari i Përgjithshëm mbështet drejtpërdrejt nga një Zyrë Private dhe një Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm, i cili ndihmon Sekretarin e Përgjithshëm dhe i zëvendëson në mungesë të tyre. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm është gjithashtu kryetar i një numri komitetesh të larta, grupe ad-hoc dhe grupe pune.

Në përgjithësi, i gjithë Shtabi Ndërkombëtar në Selinë e NATO-s mbështet Sekretarin e Përgjithshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Sekretari i Përgjithshëm është një figurë e lartë politike nga një vend anëtar i NATO-s, i emëruar nga shtetet anëtare për një mandat katërvjeçar. Përzgjedhja kryhet përmes konsultimeve diplomatike jozyrtare ndërmjet vendeve anëtare, të cilat parashtrajnë kandidatë për këtë post.

Asnjë vendim nuk konfirmohet derisa të arrihet konsensusi për një kandidat. Në fund të mandatit të tyre, Sekretarit të Përgjithshëm aktual mund t'i ofrohet të qëndrojë. Ky pozicion është mbajtur tradicionalisht nga një figurë e lartë politike evropiane.

Aleanca është dhe do të mbetet gurthemeli i sigurisë sonë kolektive

Ndërsa ambasadorët e 32 vendeve anëtare të aleancës morën vendimin në një takim në selinë e NATO-s në Bruksel, më 26 qershor, për të zgjedhur kryeministrin holandez Mark Rutte si shefin e ardhshëm të NATO-s, lufta në Ukrainë vazhdon dhe aleanca transatlantike përballlet me paqartësi rreth qëndrimit të ardhshëm të Shteteve të Bashkuara ndaj saj.

Emërimi i z. Rutte u shndërrua në një formalitet pasi rivali i tij i vetëm për këtë post, presidenti rumun Klaus Iohannis, njoftoi

Aleatët e NATO-s zgjedhin Mark Rutte si Sekretarin e Përgjithshëm të ardhshëm



javën e kaluar se hoqi dorë nga gara, pasi nuk arriti të sigurojë mbështetje. Z. Mark Rutte do të marrë detyrën më 1 tetor nga z. Jens Stoltenbergu, i cili do të largohet pas shërbimit prej një dekade në këtë post.

Z. Rutte tha se ai pret me padurim të marrë përsipër punën, ndërsa nënvizoi se “aleanca është dhe do të mbetet gurthemeli i sigurisë sonë kolektive. Udhëheqja e kësaj organizate është një përgjegjësi që nuk e marr lehtë”, - shkroi ai në rrjetin X.

Pasi shpalli interesimin e tij për postin vitin e kaluar, z. Rutte fitoi herët mbështetjen e vendeve kryesore anëtare të aleancës, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Britaninë, Francën dhe Gjermaninë. Të tjerët ishin më të rezervuar, veçanërisht vendet e Evropës Lindore, si Hungaria, Sllovakia dhe Rumania, të cilat argumentuan se posti duhej t'i takonte dikujt nga rajoni i tyre për herë të parë. Por ata mbështetën z. Rutte, i cili është një kritik i ashpër i presidentit rus Vladimir Putin dhe një aleat i vendosur i Ukrainës. Ai ka qenë një nga mbështetësit më të mëdhenj të ndihmës ushtarake evropiane për Ukrainën, që kur Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të saj në vitin 2022. Mundja në fushëbetejë e Rusisë është jetike për të siguruar paqen në Evropë, thotë Rutte.

Nën udhëheqjen e tij, Holanda ka rritur shpenzimet e mbrojtjes në më shumë se 2% të prodhimit të brendshëm bruto, prag ky që u kërkohej të gjitha vendeve anëtare të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg që edhe më herët ka thënë se Rutte është një kandidat “shumë i fortë” për ta zëvendësuar atë, e mirëpriti ngrohësisht zgjedhjen e zotit Rutte si pasardhësin e tij. “Marku është një transatlantik i vërtetë, një udhëheqës i fortë dhe një ndërtues i konsensusit”, - tha ai. “E di që po e lë NATO-n në duar të mira”.

NATO i merr vendimet me konsensus, kështu që zoti Rutte 57 vjeç, i cili po largohet nga politika holandeze pas gati 14 vitesh si kryeministër, mund të konfirmohet vetëm pasi të 32 anëtarët e aleancës t'i jepnin atij mbështetjen e tyre. Por ndërkohë z. Rutte do të përballlet me sfidën e ruajtjes së mbështetjes së aleatëve për luftën e Ukrainës kundër agresionit të Rusisë dhe shmangies së përfshirjes së drejtpërdrejtë të NATO-s në një luftë me Moskën. Anëtarësimi i Ukrainës në NATO është një sfidë tjetër gjithashtu.

Nën drejtimin e Jens Stoltenberg, i cili mori detyrën e shefit të NATO-s në vitin 2014, aleanca ushtarake u zgjerua me katër anëtarë të rinj, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Finlandën dhe Suedinë. Nën udhëheqjen e tij, NATO përforcoi edhe misionin e saj paqeruajtës në Kosovë vitin e kaluar, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, ndërsa Asambleja Parlamentare e aleancës miratoi avancimin e statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar.

Mark Rutte ka qenë në krye të qeverisë holandeze që nga viti 2010 dhe tek kryeministri i Holandës dhe autoritetet në Kosovë shohin një partner me të cilin mund të bisedojnë për një gamë të gjerë çështjesh, nga avancimi i vendit në rrugën drejt integritetit në Bashkimin Evropian deri të siguria dhe stabiliteti afatgjatë. Vizitën e fundit në Kosovë z. Rutte e zhvilloi korrikun e kaluar, ku së bashku me homologun e Luksemburgut, i bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të ulnin tensionet dhe t'i ktheheshin dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Tensionet mes dy vendeve ishin në kulm, pasi në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës pushtetin e morën kryetarët e zgjedhur shqiptarë. “U bëjmë thirrje të dyja palëve që të marrin pjesë në dialogun e udhëhequr nga Bashkimi Evropian, ta shtensionojnë situatën dhe përfundimisht t'i normalizojnë marrëdhëniet”, - ka shkruar Rutte në platformën X. Ndërkohë që Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, nga ana e saj e cilësoi atëherë takimin me dy udhëheqësit evropianë si mundësi për të diskutuar “përpjekjet

për forcimin e bashkëpunimit, avancimin në rrugën drejt BE-së dhe përkushtimin e përbashkët për paqen, sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë në kontinent”.

Por gjithashtu Holanda (dhe ish-kryeministri i kohës Jan Peter Balkenende) ka qenë një prej shteteve që e njohën pavarësinë e Kosovës brenda muajit të parë pas shpalljes, më 2008. Kur z. Rutte mori detyrën e kryeministrit pas dy vitesh më vonë, në tetor të 2010-ës dhe në dhjetor të 2013-ës, ai priti në zyrën e tij presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga, së cilës i shprehu mbështetjen e Holandës për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së. Kjo marrëveshje, e para kontraktuale mes dy palëve, u nënshkrua në vitin 2015.

Qeveria holandeze së bashku me atë të Francës, për një periudhë të caktuar, ishin kundërshtarë të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Një qëndrim që nxiti dhjetëra deputetë të Parlamentit Evropian t'i shkruanin letër kryeministrit Rutte dhe presidentit francez Macron në vitin 2020, për t'iu kërkuar dritën jeshile për lëvizjen e lirë të kosovarëve. Nga ajo kohë, procesi kaloi në disa faza dhe vizat u hoqën nga 1 janari i këtij viti. Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani tha në vitin 2021 se ishte përshëndetur me z. Rutte në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, dhe se ajo “është mirënjohëse për mbështetjen dhe bashkëpunimin” e z. Rutte. Gjithashtu ajo ka takuar z. Rutte në samitin e Komunitetit Politik Evropian, i cili u mbajt në tetor të vitit të kaluar në Granadë të Spanjës, ku Osmani tha se në atë takim u fol për situatën e sigurisë në Kosovë, pas sulmit të armatosur të një grupi serbësh në pjesën veriore të vendit. Dhe së fundmi presidentja kosovare takoi z. Rutte në margjinat e samitit për paqen në Ukrainë, që u mbajt në Zvicër, javën e kaluar. “Samiti ishte një mundësi e shkëlqyer për të biseduar me kryeministrin holandez, Mark Rutte, për rëndësinë e së ardhmes euroatlantike të Kosovës”, - shkroi Osmani në X.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerëson rolin udhëheqës të Francës

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg u takua me Presidentin Emmanuel Macron në Paris, për të diskutuar përgatitjet për Samitin e Uashingtonit në korrik.

Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi rolin kyç të Francës në Aleancë, duke përfshirë kontributin e saj në mbrojtjen kolektive në krahun lindor me dislokime në Rumani dhe Estoni. Ai falënderoi gjithashtu presidentin Macron për “kontributet e Francës në policimin ajror të NATO-s në qiejë e Baltikut dhe në fushën detare, ku anijet detare franceze i mbajnë korsi të tona detare të hapura dhe të sigurta”. Më tej ai nënvizoi se forcat bërthamore të Francës kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme të Aleancës.

Stoltenberg e quajti më shumë mbështetje për Ukrainën “detyrën tonë më urgjente” për Samitin e Uashingtonit, duke thënë se ai pret që aleatët të bien dakord që NATO të udhëheqë koordinimin dhe ofrimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë për Ukrainën. Ai ka propozuar edhe një angazhim financiar afatgjatë. “Mbështetja jonë nuk ka të bëjë me bërjen e NATO-s palë në konflikt; ka të bëjë me sigurimin që Ukraina të mund të mbrojë të drejtën e saj për vetëmbrojtje”, - tha ai.

Forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s do të jetë një tjetër temë kyçe në Samit dhe z. Stoltenberg mirëpriti që 23 aleatë rekord, përfshirë Francën, do të investojnë të paktën 2 për qind të PBB-së në mbrojtje këtë vit.

“Ne do të trajtojmë gjithashtu çështje të tjera të rëndësishme në Samit, duke përfshirë punën me Bashkimin Evropian dhe partnerët tanë Indo-Paqësor. Dhe vendimet që do të marrim në Uashington do të forcojnë Aleancën tonë për të ardhmen”, - përfundoi Sekretari i Përgjithshëm.


Teknologjia Radikale synon të ringjallë fuqinë e oqeanëve për të ftohur botën

Oqeanet ndihmojnë në ftohjen e botës. Startupet po ngrenë lart idenë se mund të ndryshojnë kiminë e deteve për t'i bërë ata ta bëjnë edhe më shumë këtë funksion. Është një ide radikale që ende nuk është provuar në shkallë komerciale dhe i bën disa të shqetësohen për rreziqet e mundshme. Por të paktën shumë kompani të reja po ndërmarrin projektet e para të mëdha në botë për t'i bërë oqeanet të thithin më shumë dioksid karboni, të inkurajuar nga miliarda dollarë financime federale dhe korporative për përpjekjet që largojnë gazin serrë nga atmosfera.

Një startup që përdor një metodë elektro-kimike për të hequr karbonin nga uji i detit po ndërton uzinat e tij të para në shkallë komerciale në Singapor dhe Quebec. Heqja e karbonit rrit aftësinë e oqeanit për të thithur më shumë nga atmosfera. Qeveria e SHBA-së së fundi i dha asaj dhe një konkurrenti me një qasje të ngjashme disa nga fondet e para federale për heqjen e karbonit.

Një tjetër startup është vendosur të derdhë rreth 9 000 tonë rërë të përzier me një mineral të verdhë-jeshile të quajtur olivin pranë ujërave në brigjet e jashtme të Karolinës së Veriut. Kur rëra tretet në ujë, ajo shkakton një sërë reaksionesh kimike që nxisin heqjen e karbonit.

“Oqeani në thelb bën punën për ne”, - tha Tom Green, shefi ekzekutiv i Vesta, i cili po fillon projektin e Karolinës së Veriut.




përdorimin e makinave të ngjashme me vakum për të pastruar karbonin nga ajri. Marrja e oqeanëve të gjera për të thithur më shumë karbon është një nga qasjet potencialisht më të fuqishme që po ndiqen.

Tashmë, oqeanet thithin rreth 30% të karbonit atmosferik të Tokës. Shkencëtarët thonë se teknologjitë e reja që përdorin oqeanin mund të heqin përfundimisht të paktën 1 milion tonë metrikë më shumë në vitet e ardhshme. Kjo do të ishte gati katër herë më shumë sesa e gjithë industria e heqjes së karbonit ka ofruar deri tani; një milion tonë metrikë është afërsisht ekuivalente me emetimet vjetore të më shumë se 200 000 makinave të pasagjerëve me benzinë.

Nxitja e rritjes së sektorit: korporatat e etura për të blerë kredi për heqjen e karbonit për të kompensuar ndikimin e tyre mjedisor. Kompanitë janë zotuar të paguajnë për rreth 2.6 miliardë dollarë kredi për heqjen e karbonit, nga afërsisht 55 milionë dollarë në fillim të vitit 2022, sipas ofruesit të të dhënave CDR. Kreditë mbështesin heqjen e rreth 10 milionë tonë metrikë karbon.

Shitjet e kredive për heqjen e karbonit të lidhura me metodat që përfshijnë oqeanin përbëjnë të paktën 100 000 tonë metrikë, një pjesë e vogël e totalit. Por pothuajse e gjithë kjo është shitur vitin e kaluar.

“Captura Corporation”, një startup i Institutit të Teknologjisë



në Kaliforni, ka zhvilluar një plan revolucionar për të hequr emetimet e karbonit, duke krijuar një strukturë pastrimi ujore në mes të detit. Kompania synon të nxjerrë dioksid karboni nga uji i oqeanit dhe të lëshojë ujin e pastruar përsëri në oqean, duke përdorur vetëm energjinë elektrike të rinovueshme dhe ujin e oqeanit si inpute për të minimizuar ndikimin mjedisor.

Vesta tha se puna e saj në Karolinën e Veriut do të heqë rreth 6 000 tonë metrikë karbon gjatë disa viteve. Përzierja e saj e rërës vepron si një antacid, duke rritur alkalinitetin e ujit dhe aftësinë e tij për të thithur më shumë karbon. Kompania më parë kreu atë që tha se ishin kërkime premtuese në Republikën Dominikane, por vendosi se vende të tjera do të ishin më të mira për vendosjet fillestare. Më pas kreu një test të suksesshëm në shkallë të vogël në Nju Jork.

“Equatic”, startup që përdor elektrokiminë, po bën gjithashtu projektet e tij të para të dukshme pas operimit të një objekti të vogël pilot në Kaliforninë Jugore. Një rrymë elektrike i ndan elementët në ujë, dhe karboni i tretur më pas ruhet si i ngurtë.

Materiali i ngurtë mund të përdoret për ndërtim, ndërsa hidrogjeni i mbetur mund të shitet si lëndë djegëse e pastër për industrinë e rënda, tha Edward Sanders, shefi operativ i kompanisë. “Equatic” përdor sensorë gjatë gjithë procesit të tij

për t'u siguruar që teknologjia po heq karbonin.

Teknologjia e monitorimit është po aq e rëndësishme sa heqja e karbonit, sepse ajo mbështet marrëveshje të tilla si ajo e “Equatic” e arritur me “Boeing” vitin e kaluar, e lidhur me heqjen e 62 000 tonë metrikë karboni.

“Ne nuk mund t'i shesim një ton karboni të hequr “Boeing-ut” nëse nuk mund ta matim atë”, - tha Sanders. “Dhe ata nuk do të na paguajnë derisa ne të mund ta matim atë”.

“Equatic” dhe një startup tjetër me një qasje të ngjashme të quajtur “Ebb Carbon” së fundmi fituan fonde nga Departamenti i Energjisë. Ata janë ndër kandidatët për t'i dhënë qeverisë kredi për heqjen e karbonit përmes një programi të ri blerjeje.

Kompanitë kanë ende një rrugë të gjatë për të bërë për të treguar se heqja e karbonit mund të jetë një biznes financiarisht i qëndrueshëm. “Running Tide”, një nga kompanitë më të avancuara në industri, kohët e fundit tha se po mbyllet papritur pasi dështoi të shesë kredi të mjaftueshme të karbonit dhe të mbledhë paratë që i nevojiteshin për të mbijetuar.

Kompania kishte mbledhur më parë dhjetëra miliona dollarë dhe kishte shitur kredi karboni për kompanitë, duke përfshirë “Microsoft” dhe firmën e tregtisë elektronike “Shopify”. Vitin e kaluar, “Running Tide” hoqi më shumë se 20 000 tonë metrikë karbon të lidhur me kreditet e largimit, ndër më të shumtët deri më tani për të gjitha metodat e heqjes së karbonit.

Kompania mbledhi material bimor që merrte natyrshëm karbon kur rritej dhe nuk kishte ndonjë përdorim komercial, më pas e varrosi thellë nën ujë pranë Islandës. Ky material i mbeturinave përndryshe do të lëshonte karbon kur digjet ose dekompozohet, kështu që parandalimi i kësaj dhe ruajtja e materialit për të paktën qindra vjet është një formë e heqjes së karbonit. Shumë kompani po përdorin qasje të ngjashme në tokë. Institucioni Oqeanografik “Woods Hole” është ndër grupet që testojnë efektivitetin e këtyre përpjekjeve. Këtë verë, studiuesit nga laboratorit po planifikojnë të shtojnë një formulë alkaline në ujërat në jug të Vreshtit Martha dhe të matin se sa karbon absorbohet.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit tha së fundmi se po kërkon komente publike për lejet për projektin. Zyrtarët e EPA-s thanë se projekti WHOI paraqet pak kërcënim për jetën detare, por disa grupe mjedisore shqetësohen se ndërhyrja me kiminë e oqeanit mund të ketë pasoja të padëshiruara.

“Ne duam të sigurohemi që shkenca më e mirë e pavarur të peshojë mbi atë që mund të jetë gjëja më thelbësore që do t'i ndodhë këtij planeti”, - tha Peter de Menocal, presidenti i laboratorit kërkimor.



Përgatitja e një objekti në shkallë të gjerë “Captura” që kap dioksid karboni nga uji i oqeanit “Captura Corporation”

Marina Amerikane mund të bëhet një central lazeri

Pavarësisht mbi një dekadë kërkimesh dhe investimesh në lazer me energji të lartë (HEL) dhe mikrovalë me fuqi të lartë (HPM), Marina e SHBA-së ende nuk i ka vendosur këto teknologji në mënyrë efektive. Marina e SHBA-ve po zhvillon sisteme si HELIOS, të cilat mund të integrohen në anijet ekzistuese, por kostot e larta të zhvillimit dhe sfidat e vendosjes mbeten. Megjithatë, përfitimet afatgjata të kostos së laserëve, të cilët kushtojnë më pak se 1 dollar për goditje, i bëjnë ato një investim të vlefshëm.

A mund të arrijë Marina e SHBA-ve, përparimet dhe sfidat e armëve lazer?

“Kur isha në Bahrein si oficer komandues i Skuadronit të Shkatërruesve 50, 10 vjet më parë, baza detare USS Ponce kishte një lazer në të”, - u tha gazetarëve zv/admirali Brendan McLane përpara konferencës së Shoqatës së Marinës së Sipërfaqes, muaj më parë.

Siç theksoi gjithashtu “Navy Times”, “Lazerët me energji të lartë, ose HEL, dhe mikrovalët me fuqi të lartë, ose HPM, do t’i ofronin flotës sipërfaqësore një tjetër armë për të luftuar kërcënimet ajrore, duke përfshirë mjetet ajrore pa pilot dhe raketat. Pavarësisht dekadave të kërkimit dhe zhvillimit dhe miliarda dollarë të shpenzuara për një kërcënim si ai me të cilin Marina tani përballet në Detin e Kuq, sisteme të tilla duhet të hyjnë ende në flotën sipërfaqësore dhe ushtrinë më të gjerë në një mënyrë kuptimplote, sipas analistëve të jashtëm dhe drejtuesve të shërbimit”.

Duhet shtuar më tej se komentet e McLane vijnë pasi Marina Mbretërore kohët e fundit testoi platformën e saj “DragonFire”, e cila ishte në gjendje të godiste një monedhë 1£ nga një distancë deri në një kilometër larg, njoftoi Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar (MoD).

Përveç saktësisë së saj ekstreme, platforma “DragonFire” e Mbretërisë së Bashkuar mund të angazhojë objektiva me shpejtësinë e dritës, ndërsa rrezja e saj intensive e dritës mund të kalojë fjalë për fjalë objektivin, duke çuar në dështim strukturor ose rezultate më me ndikim - si p.sh. nëse koka e raketës hyrëse është në shënjestër.

Pra, pse Marina e SHBA-ve nuk ka një HEL të ngjashëm me



drejtëpërdrejtë për të përvetësuar, synuar, gjurmuar dhe shkatërruar objektivat e dronëve në sulme me rreze të shkurtër, sulme të grupeve dhe skenarë të kërcënimit me rreze të gjatë.

H4 është sistemi i katërt operacional i armëve lazer që

anijet ekzistuese dhe të siguronte aftësi të drejtuara energjetike për flotën.

Raportohet se është i integruar dhe i shkallëzueshëm nga dizajni, sistemi HELIOS me shumë misione thuhet se do të jetë në gjendje të ofrojë aftësi luftarake të sistemit të armëve lazer taktikisht të rëndësishme si një element kyç i arkitekturës së mbrojtjes me shtresa. Sistemi HELIOS mund të mbështesë më tej misionet e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit (ISR) me rreze të gjatë.

“Lockheed Martin” iu dha kontrata e Sistemit të Armëve Lazer Sipërfaqësore të Marinës Amerikane (SNLWS) Increment 1, i njohur si HELIOS, në janar 2018 dhe ka bërë përparim të qëndrueshëm në këtë prototip të Energjisë së Drejtuar të Shpejtë.



“DragonFire”?

Në fakt nuk është për mungesë përpjekjesh – dhe teknologjia që dikur ekzistonte vetëm në fushën e fantashkencës po bëhet ngadalë realitet.

Kjo do të thotë, një ditë së shpejti, Marina e SHBA-ve mund të jetë një fuqi e vërtetë lazer.

Përpjekjet e Forcave Ajrore të SHBA-ve

Verën e kaluar, Qendra e Menaxhimit të Ciklit të Jetës së Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara dhe “Raytheon Technologies” njoftuan testin e parë të suksesshëm të armës së parë lazer me energji të lartë të paletizuar të Forcave Ajrore. Testet u kryen gjatë katër ditëve të ushtrimeve të vazhdueshme me gjuajtje të drejtëpërdrejtë në rreze e raketave “White Sands” në New Mexico.

E njohur si “H4”, arma lazer e paletizuar u zhvillua për të mbrojtur njerëzit dhe asetet kundër kërcënimeve ajrore me rreze të shkurtër veprimi. Ai ka kaluar planin e testimit dhe vlerësimit të Forcave Ajrore, i cili përfshinte disa ditë ushtrime me gjuajtje të

“Raytheon Technologies” i ka dorëzuar Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Është gjithashtu sistemi i tetë total që kompania i ka dorëzuar Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve (DoD).

Të njohura edhe si “armë me energji të drejtuar” (DEWs), këto janë parë si një shumëzues serioz i forcës, kjo është arsyeja pse kaq shumë theks i është vënë zhvillimit të tyre. Këto kanë përfshirë përpjekjet në sistemet me mikrovalë me fuqi të lartë (HPM) dhe lazer me energji të lartë (HEL).

Marina e SHBA-së ka punuar për më shumë se një dekadë në përpjekje të ndryshme për të pajisur anijet luftarake me armë lazer që mund të ngatërrojnë ose shkatërrojnë sistemet e armikut. Kërkesa buxhetore e shërbimit për vitin fiskal 2023 (FY23) kishte kërkuar më shumë se 103 milionë dollarë për të mbështetur gjysmë duzine koncepte të armëve lazer.

Ishte në gusht 2022, kur “Lockheed Martin” njoftoi se i kishte dorëzuar Marinës së SHBA-ve një lazer me energji të lartë të klasit 60+ kW me verbues optik të integruar dhe mbikëqyrje (HELIOS). Ishte sistemi i parë taktik i armëve lazer që mund të përfshihej në



Kursime të kostos në lazer

Megjithëse zhvillimi i armëve mund të jetë i kushtueshëm, në planin afatgjatë do të ishte një investim vërtet i vlefshëm.

Muaj më parë, DEW-të mund të ndihmonin anijet luftarake të ruanin furnizimet e tyre përkatëse të municioneve të fundme ndërsa ishin në stacion. Mbi 60 përgjimet e konfirmuara të dronëve dhe raketave që synonin anijet luftarake të marinës amerikane dhe anijet tregtare në Detin e Kuq janë mbështetur kryesisht në “Standard Missile-2”, ose SM-2, megjithëse zyrtarët e shërbimit nuk kanë pranuar të thonë saktësisht se çfarë është gjuajtur në çdo angazhim.

Një nga përfitimet e qarta të lazerëve dhe DEW-ve të tjera është çmimi. Në vend që të shpenzoni në raketa që kushtojnë diku nga dhjetëra mijëra deri në miliona dollarë secila, për t’u prodhuar, një lazer varet vetëm nga prodhimi elektrik, i cili mund të gjenerohet për më pak se 1 dollar për goditje.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Dëshmorë nga Çamëria, rënë për lirinë e Shqipërisë

Xhezmi Delli lindi në Tiranë në vitin 1918, ku në rrugicën “Sulejman Pasha”, në një lagje të vjetër të saj, gjendej shtëpia e familjes Delli, me numrin e portës 39. Prindërit e tij kishin ardhur nga Margëlliçi dhe ishin vendosur në Tiranë. Shtëpia ishte prej qerpiçi dhe e vjetër, e ndarë në tri dhoma të vogla. Në njërën nga dhomat e kësaj shtëpie, në kohën e reaksionit më të egër, gjatë viteve 1942-1943, bëheshin vazhdimisht mbledhje të drejtuesve të PKSH-së, që punonin ilegalisht në Tiranë. Në shtëpinë përdhese të familjes Delli vinin të maskuar me veshje të ndryshme, herë si punëtorë, elektrikistë e herë si intelektualë, antifashistët dhe luftëtarët e lirisë Gogo Nushi, Beqir Balluku, Kozma Nushi, Fiqrete Sanxhaktari (Shehu), Nexhmie Xhuglini (Hoxha), Abdyl Këllezi, e të tjerë, ku merrnin udhëzime dhe orientime nga Tarasi, drejtuesi kryesor i PKSH-së.

Shtëpia ishte bazë e luftës dhe këtu bëheshin mbledhje të qarkorit, mbledhje organizatash Partie dhe Rinie etj. Pozicioni i shtëpisë ishte i atillë që lejonte, në rast nevojë, largimin me lehtësi të shokëve, përmes bahçeve, që lidheshin me njëra-tjetrën deri në rrugën e Fortuzit, pranë burgut. Ka ndodhur shpesh që ilegalët pas shumë orë pune, shtroheshin këmbëkryq në sofër bashkë me pjesëtarët e familjes Delli. Midis tyre gjendej dhe Enver Hoxha, i cili me thjeshtësinë dhe përzemërsinë e tij, dukej si djalë i shtëpisë. Nga kjo shtëpi niseshin për aksione anëtarë të njësiteve guerile të Tiranës, të cilët, në mes të ditës, kryenin aksione të guximshme. Kjo shtëpi e vogël, ishte bërë qendër e rëndësishme e aktivitetit revolucionar të antifashistëve dhe tërhoqi vëmendjen e armikut. Në orët e vona të një nate maji të vitit 1942, pushtuesit dhe tradhtarët e rrethuan shtëpinë. Në mënyrën më barbare, shkëputën nga gjiri i familjes djalin e shtëpisë Xhezmi Dellin. Atë e torturuan dhe i bënë presion që të tregonte për lëvizjen, por fashizmi dhe tradhtarët nuk e përkulën luftëtarin. Për mungesë faktesh e liruau. Shtëpia e tij mbeti përsëri strehë dhe bazë e ilegalëve. Në demonstratën e madhe të organizuar përpara burgut, ku u vra nga plumbat e fashizmit nëna Mine Peza dhe u plagosën shumë të tjerë, shtëpia u bë qendër, ku u grumbulluan më se dyzet vajza të reja, të cilat, të mbuluara me çarçaf, kishin marrë pjesë atë ditë në demonstratë. Shtëpia u diktua nga fashistët, spiunët dhe tradhtarët, të cilët e rrethuan atë dhe me forca të mëdha arrestuan të gjithë sa ndodheshin brenda. Që nga kjo kohë, shtëpia u bë objekt gjurmimi të vazhdueshëm nga fashistët dhe tradhtarët.

Në muajin prill të vitit 1943, i deleguar i Komitetit Qarkor të Tiranës, Xhezmi Delli mori pjesë së bashku me patriotë nga parti në një mbledhje me disa përfaqësues, krerë të Ballit Kombëtar. Në mbledhje Xhezmiu mbrojti me vendosmëri Lëvizjen dhe luftën kundër fashizmit dhe nuk ishte dakord me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar për qëndrimin e tyre. Po kështu Xhemziu kundërshtoi dhe kompromisin e BK-së me fashistët dhe sidomos protokollin “Dalmazzo-Ali Këlcyra”. Këtu Xhezmiu u ekspozua shumë. Drejtuesit e lëvizjes në Tiranë e porositën të largohet nga Tirana, se qëndrimi i tij ishte në rrezik. Pas kësaj mbledhjeje, në ato ditë Xhemziu po përgatitej për t’u hedhur në ilegalitet, organet e fashizmit, spiunët e tij (SIM-i) në bashkëpunim me tradhtarët e rrëmbyen Xhezmiun. Që prej datës 23 prill 1943, Xhemziu u zhduk mizorisht nga fashizmi. Për të përjetësuar emrin e Xhezmi Dellit, në Tiranë në Njësinë Administrative nr. 3 është shkollë 9-vjeçare me emrin “Xhezmi Delli”. Është shkruar në librin “Yje të Pashuar” në vëllim I, Tiranë, 1971, f. 226.

Nuk e lëshoi pozicionin për 55 ditë luftë

Zihni Elamaz Shaqiri ka lindur në Shqefar, pranë Konispolit, më 14 prill 1927, në një familje të thjeshtë punëtori. Në shkollën e Konispolit, Zihniu ishte nxënës i sjellshëm dhe i zellshëm për dije. Babai, Elmazi kishte dëshirë që i biri të kryente një shkollë të mesme. Por në vitin 1937 babai vdes dhe Zihniu mbeti jetim. Ishte 10 vjeç kur la shkollën dhe u detyrua të punojë për të mbajtur nënën, tre vëllezër dhe motrën. Ai u detyrua të punojë në punë të rënda dhe mbi supet e tij të njomë provoi barrën e shtypjes, fyerjen e poshtërimit. Kur fashizmi italian sulmoi Shqipërinë Zihniu ishte 12 vjeç. Në janar të vitit 1943 Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare në krahinën e Konispolit po zgjerohej dhe po krijoheshin formacione dhe njësi partizane për luftë kundër armikut dhe tradhtarëve, Zihniu u bashkua me të rinjtë antifashistë. Në korrik të vitit 1943 mori pjesë aktive në komandën partizane të vendit, që në këtë kohë kryente funksione të rëndësishme për Frontin Nacionalçlirimtar, duke kryer detyrën e korrierit. Më 5 gusht 1943, në ditën e parë që forcat partizane u ndeshën me forcat gjermane që vinin nga Sajadha e Greqisë për të kaluar në Qafë Botë, Zihniu 16 vjeçar u rreshtua partizan në çetën e parë të batalionit “Çamëria”. Ai mori pjesë në të gjitha luftimet e mëvonshme që ndërmori batalioni kundër armikut dhe luftoi si anëtar i denjë i rinisë shqiptare.

Më 20 gusht 1943, nazistët gjermanë të udhëhequr nga ballistë dhe tradhtar ndërmorën një sulm të paparë kundër zonës së Konispolit. Armiku goditi me artleri të rëndë, sulmoi pozicionet partizane në Likojan dhe në Qafë Botë. Lufta ishte e rreptë. Zihniu edhe pse ishte me temperaturë, nuk u nda nga llogoret e luftës, rezistoi dhe luftoi bashkë me shokë. Temperatura nuk po i ulej dhe

‘Të luftojmë që të mos turpërohemi para brezave...’



ishte mjaft i sëmurë, komisari i çetës urdhëroi që të shkonte pranë familjes së tij të shpërngulur nga lufta në fshatin Klogjer. Ai shkoi, u takua me nënën, vëllezërit dhe motrën, duke u thënë: “Erdha t’u shoh për t’u çmallur, nuk prish punë se jam në ethe, ato do të kalojnë. Më duhet me çdo kusht të kthehem tek shokët sonte, sepse luftën e kemi në prag të derës. Armiku do goditur”. U përqaftua me të gjithë dhe ashtu i zhuritur nga ethet, u dha këmbëve për tek shokët që ishin në luftë. Dita e 27 shtatorit 1943 ishte vendimtare për armikun e gjakatosur rëndë në 55 ditë beteje me partizanët e batalionit “Çamëria”, si dhe forcat territoriale të të gjithë krahinës së Konispolit dhe të Vurgut. Armiku sulmoi me forca të shumta. Plani i armikut ishte që t’u impononte forcave tona të pakta në numër një luftë frontale për t’i asgjësuar lehtë, por nuk ja arriti dot qëllimit. Në luftimet e kësaj dite ishte dhe Zihniu që luftonte... Në Butas ra. Copa të predhës së murtajës e kishin marrë në kokë dhe në kraharor...

Për dëshmorin u bë kënga: Zihni partizani, lule e rinisë,/ Zot i dole vendit, luftëtari i lirisë,/ Hije të kish shtati, pushka dhe gjerdani,/ I kuq të ndriste ylli, Zihni partizani.

Është shpallur dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me vendim nr. 166, datë 27 dhjetor 1977 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Sarandës. Është shkruar në librin “Yje të Pashuar” në vëllim XI, Tiranë, 2002, f. 269.

Antifashisti Ali Demi, biri i Çamërisë që ra në Labëri

Biri i Çamërisë së sflitur nga shovinizmi grek, Ali Demi, i gjendur familjarisht në Tiranë, do të jepte një ndihmesë të shquar në organizimin e qëndresës popullore kundër fashizmit në krahina të ndryshme të Shqipërisë si në Tiranë, Çermenikë, Kërrabë, Zaranik dhe në trevën e Labërisë e kryesisht në Vlorë dhe në krahinën e Mesaplikut. Tashmë dihet botërisht se më 29 prill 1943, antifashisti Ali, së bashku me 26 të burgosur politikë të tjerë, pas një pune këmbëngulëse dhe në heshtje të plotë, hapën një tunel të nëndheshëm dhe u arratisën nga burgu i Tiranës. Menjëherë Ali Demi shkoi në Çermenikë, ku kreu detyrën e komisarit të çetës në batalionin e Çermenikës, duke kryer disa luftime në Shqipërinë e Mesme. Në fund korriku 1943, u dërgua me detyrë sekretar i Qarkorit të Partisë Komuniste për Vlorën dhe më pas si sekretar politik. Në krye të kësaj detyre Aliu u gjend kudo në fshatrat e krahinës së Mesaplikut dhe në qytetin e Vlorës, së bashku me të deleguarit e tjerë Ramize Gjebrea, Andrea Varfi, Lefter Kasneci, Selim Alimerko etj.

Trimëria dhe guximi i tij spikatën në luftimet e zhvilluara në këtë periudhë në qarkun e Vlorës. Ai dha një ndihmesë në formimin e çetave partizane të Bregdetit, “Bashkimi” të Topalltisë, “Sali Murati” të Vranishtit, “Myzeqesë” të Myzeqesë së Vogël në Vlorë, të “Halim Xhelo” e “Avni Rustemi”. Ai mori pjesë si luftëtar në Luftën e Drashovicës, ishte në Vranisht për krijimin e Gr. 2 Partizan të Vlorë, më 30 tetor 1943, ishte anëtar i Shtabit të ZIOP që në fillim të tetorit 1943. Punoi fort në përgatitjen për krijimin e Br. VS, të formuar më 28 nëntor 1943, në Gumenicë të Vlorës. Ali Demi dhe një ndihmesë të dukshme në ngritjen e pushtetit ushtarak të prapavijës në komandën e Qarkut Vlorë, në Komandat e Vendit në Topallti, Drashovicë, Brataj, Kuç, si dhe organizimin e Rojës Partizane Vullnetare Fshatare.

Duke qenë gjithnjë në lëvizje, Aliu kishte rënë në sy të pushtuesit dhe të tradhtarëve. Në mbrëmjen e 19 dhjetorit 1943, duke u kthyer natën vonë në bazën e tij në Kaninë, dhe pse në kalanë e Kaninës kishte gjermanë. Baza e tij ku strehohej ishte rrethuar nga gjermanët e ballistët. Thirrjes së tyre për t’u dorëzuar, Aliu me dy shokët, iu përgjigj me grykën e maliherit. Mbi ta filluan të bien edhe predha artilerie e mortajash. U vra shoku i tij Pano Dhimëgjoka. Plagoset Dhimitër Mandro, shoku tjetër. Aliu për të mos rënë i gjallë në duart e armikut, çan rrethimin, por te qafa e Dheut të Bardhë goditet dhe bie në fushën e nderit si trimat...

Më 9 korrik 1945, Këshilli i Përgjithshëm Antifashist, i jep titullin më të lartë, plotësisht të meritueshëm, “Hero i Popullit”.

Emrin e Ali Demit e mbajnë rrugë dhe shkolla të ndryshme në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë dhe në Vlorë. Për të janë shkruar libra, monografi, poezi, janë bërë buste dhe është pasqyruar në artet figurative. Ai është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 104, datë 20.06.1977, të Komitetit Ekzekutiv Tiranë dhe varri i tij gjendet në varrezat e Dëshmorëve në Vlorë. Në këtë manifestim për Antifashizmin çam, në 80 vjetorin e Çlirimit të Atdheut, populli i trevës së Labërisë përulet me nderim para veprës së lartë atdhetare të birit të shquar të Çamërisë, Ali Demi. Ai i përket Vlorës heroike, pasi dha jetën në luftë me pushtuesit gjerman dhe reaksionin në kalanë legjendare të Aranitëve. Antifashisti ngeli përjetësisht në Vlorë për t’u treguar brezave heroizmin partizan në luftë për çlirim dhe pavarësi...

Mësuesi luftëtar çam Bido Sejko ra për Shqipërinë

Bido Sejko ka lindur në vitin 1900, në qytetin e Filatit në Çamëri. Babai i tij, Haki Sejko ishte një patriot dhe i dëgjuar në krahinën e Çamërisë, burrë me autoritet dhe

luftëtar. Bido në Filat nisi shkollën, ku mësues pati atdhetarë të shquar si Qamil Izet Gamin, Rexhep Hamit Demin etj. Ai u rrit me ndjenjën e frymës patriotike, kur shikonte se në shtëpinë e tij, babai si kryetar i klubit kombëtar të Filatit, organizonte mbledhje. Në shtëpi mblidheshin mjaft njerëz sa dhoma e pritjes së miqve mbushej plot. Kështu sa herë në shtëpi vinin njerëz, ai vishej me rroba të reja dhe përshëndeste ata burra të moçëm dhe fisnikë, që kuvendonin me orë të tëra për fatet e krahinës dhe të vendit. Në këtë kohë Bido ishte nxënës me studime në Torino. Në shkollën ku mësonte ai bashkë me disa shqiptarë, personeli italian në shkollë bënte një politikë diskriminuese dhe fyese kundër popullit shqiptar dhe luftëtarëve vlonjatë. Në një nga ditët, kur një italian i quajtur Armando po villte vrer kundër luftës së popullit shqiptar, Bido, i pasuar nga shokët e tij shqiptarë iu hodh përsipër Armandos. I dha kështu një mësim të mirë. Në ato ditë duke marrë zemër nga ndërhyrja dhe mbrojtja e policisë disa elementë italianë shkruan në muret rrethues të shkollës: “Poshtë Shqipëria”. Kur Bido i pa, me një shpejtësi të madhe, i fshiu shkrimet që fyenin atdheun dhe shkroi: “Poshtë shkelësit dhe vrasësit italianë”. Bido u përjashtuan nga shkolla, si dhe e përzunë nga toka italiane. Bido, pas përjashtimit nga shkolla u kthye në vendlindje. Tashmë grekomëdhenjtë kishin krijuar kushte të padurueshme në tokën çame. Ai ishte krenar nga natyra, por dhe nga kultura familjare dhe ambienti patriotik ku u rrit dhe u formua, nuk mund t’i duronte dot veprimet djallëzore dhe të neveritshme të disa grekëve...

Për shumë vite ushtroi detyrën e mësuesit dhe dha mësim nëpër shkollat e Çamërisë, duke përgatitur dhe edukuar mjaft luftëtarë dhe patriotë për kohën. Kjo u manifestua dukshëm në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ku Shqipëria u pushtua e para nga fashistët italianë. Në fillim të vitit 1943, mësuesi doli partizan. Trimëria e rrallë dhe aftësitë e veçanta organizative të tij, spikatën gjatë luftimeve 55 ditore kundër nazistëve në Konispol. Në këto luftime mësues Bido komandoi një njësit të batalionit partizan “Çamëria”. Në janar të vitit 1944 nga ky batalion u dërgua në Brigadën VI Sulmuese (BrVIS) një kompani, ku bënte pjesë dhe mësues, tashmë luftëtar, Bido. Ai mori pjesë në mjaft luftime, por më kryesori ishte ai për marrjen e Kalasë së Margëlliçit, ku ra heroikisht Meleq Gostinishtit, i cili ishte zëvendëskomandant i batalionit të katërt të BrVIS, që mbante emrin “Naim Frashëri”. Këtë detyrë komanda e brigadës ia ngarkoi mësuesit luftëtar Bido Sejkos. Bido mori pjesë në një sërë luftimesh dhe përpjekjesh dhe në të gjitha u shqua si një luftëtar e komandant i zoti. Në luftimet që u zhvilluan gjatë vijës Brataj-Lepenicë, në luginën e Mesaplikut me forca të shumta nazistë që përpiqeshin të çanin nëpër zonën e lirë gjatë lumit të Vlorës dhe të dilnin në Kurveleshin e Sipërm, Bido, krejt papritur, duke manovruar dhe me një njësit prej 23 luftëtarësh, u doli mbas shpine dhe i goditi befas e me guxim nazistët. Sulmi ishte i befasishëm dhe i hutoi dhe i goditi rëndë armiqët, gjë që u dha mundësi forcave të tjera partizane t’i asgjësonin. Luftimi i fundit i Bido Sejkos ishte në mesditën e 22 qershorit 1944, në kreshtën shkëmbore të malit Saraqin, mbi katundin Dishat të Sarandës. Këtu, ai u ndodh përballë më se 15 nazistëve të fshehur e të strukur mbas shkëmbinjve. Ai luftoi trimërisht deri në çastin kur një plumb armik e goditi për vdekje mësuesin e dashur të krahinës, partizanin e komandantin trim Bido Sejko. Mësues Bido Sejko ishte dhe mbetet një nga figurat më të shquara të brezave të mësuesve dhe të luftëtarëve të popullit shqiptar. Ai është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekoratat: “Medalja e Çlirimit”, “Medalja e Trimërisë” dhe “Medalja e Kujtimit”. Bido Haki Sejko është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 166, datë 27.12.1977 të Komitetit Ekzekutiv të Sarandës. Për të është shkruar në shtypin e kohës si dhe në serinë e vëllimeve të “Yje të pashuar”, në vëllim 3. Emrin e tij e mban shkolla e mesme e bashkuar “Bido Sejko” në Konispol. Varri i tij gjendet në varrezat e dëshmorëve të Konispolit.

Më 28 qershor 1914, trashëgimtari i fronit të Perandorisë Austro-Hungareze, Arkiduka Franc Ferdinandi, dhe bashkëshortja e tij, Sofia, u vranë në një atentat, gjatë vizitës që po kryenin në Sarajevë, kryeqyteti i Bosnje-Hercegovinës.

Vrasësit ishin pjesëtarë të një organizate sekrete serbe. Tensionet pasuese diplomatike midis Austro-Hungarisë dhe mbretërisë së Serbisë u përshkallëzuan, derisa mes tyre shpërtheu lufta. Aleancat e ndryshme tërhiqën shpejt në luftë Rusinë, Gjermaninë, Francën, Britaninë dhe perandoritë e tyre në konflikt.

Tridhjetë e shtatë ditë pas vrasjes, kishte filluar Lufta e Parë Botërore. Deri në fundin e saj, ajo do të shkaktojte 39 milionë të vdekur nga të dyja kampet. Por Lufta e Madhe, mund të ketë ndodhur vetëm për shkak të një gënjeshtre.

Lufta e Parë Botërore filloi në thelb kur Austria i shpalli luftë Serbisë. Kjo nxiti aktivizimin e një sërë traktatesh të nënshkruara më herët si premtime të bëra vite më parë nga fuqitë europiane, që i detyronin ato t'i vinin në ndihmë njëra-tjetrës.

Sigurisht, ironia është se këto traktate ishin hartuar me synim dekurajimin e fuqive evropiane për të hyrë në luftë kundër njëra-tjetrës, një lloj Shkatërrimi i Sigurt Reciprok (MAD) i epokës para-bërthamore.

Arsyeja madhore e Austrisë për të hyrë në luftë me Serbinë, ishte vrasja e Arkidukës Ferdinand. Njeriu që qëlloi mbi të ishte Gavriilo Princip, një anëtar i “Dorës së zezë”, një shoqëri sekrete e nacionalistëve ushtarakë serbë. Ajo synonte shpëputjen e të gjitha vendeve sllave nga Perandoria Austro-Hungareze.

Pas vrasjes, Austria lëshoi një ultimatum ndaj Serbisë, duke kërkuar që qeveria serbe të denonconte dhe asgjësonte të gjitha grupimet terroriste nacionaliste në territorin e saj. Serbia nuk u pajtua me atë ultimatum, ndaj Austro-Hungaria i shpalli luftë.

Sipas historianit Tim Baçer, kjo është gënjeshtra që shtrihet në zemër të “luftës që do t'i jepte fund të gjitha luftërave”. Ai argumenton se Austria i manipuloi faktet, për të krijuar një pretekst për të pushtuar Serbinë. Gavriilo Princip ishte në fakt boshnjak, dhe për këtë arsye një qytetar i Perandorisë Habsburgase.

Familja e tij kishte rrënjë serbe, por nuk kishte jetuar atje prej qindra vjetësh. Është e vërtetë se ai u zhvendos në Serbi, ku dhe u radikalizua. Por urrejtja e tij ndaj Austrisë, u rrit kur Perandoria aneksoi në mënyrë të paligjshme Bosnje-Hercegovinën më 1908.

Perandoria e zhvendosi vëmendjen nga Princi, tek njeriu që e trajnonte dhe e furnizonte atë: Majori Vojislav Tankosiç, një oficer në ushtrinë serbe, dhe një anëtar themelues i “Dorës së Zezë”.

Nëpërmjet tij, zyrtarët në Vjenë mund të fajësonin inteligjencën ushtarake dhe mbretërinë serbe për vrasjen.

Në fakt, Serbia i druhej Austrisë, dhe Major Tankosiç shkeli politikën serbe, kur formoi “Dorën e Zezë”. Për më tepër, ambasadori serb e kishte paralajmëruar ministrin austriak të



Lufta që ndryshoi hartën e botës

Financave se Arkiduka Franc Ferdinandi mund të vritej në Sarajevë.

Austro-Hungarezët e shpërfillën këtë fakt, kur dorëzuan ultimatumin e tyre në korrik 1914. Kjo për shkak se ultimatumin u hartua në një mënyrë të tillë që të refuzohej. Ministri i Jashtëm, Konti Leopold Bertold, sipas fjalëve të tij, bëri “kërkesa të papranueshme” në ultimatum.

Në listën e kërkesave, ai kërkoi që Serbia të shkatërronte menjëherë të gjitha lëvizjet propagandistike anti-austriake, të shpërndante të gjitha organizatat nacionaliste serbe, dhe të arrestonte të gjithë ata që ishin të përfshirë në vrasje në territorin serb, duke lejuar austriakët të merrnin pjesë në hetimin dhe gjykimin e kësaj çështje.

Për habinë e Bertoldit, Serbia i pranoi të gjitha kërkesat me përjashtim të të fundit.

Austria u inkurajua nga aleatja e saj, Gjermania. Britania u përpoq të organizonte një konferencë ndërkombëtare për të parandaluar një luftë botërore, por Gjermania e refuzoi.

Ajo i premtoi Austrisë një mbështetje të gjerë ushtarake. Madje Ministria e Jashtme gjermane, e mbajti Kajzerin Vilhelm II jashtë

vendit gjatë gjithë krizës, në mënyrë që ai të mos kishte mundësi të “ndërhynte me idetë e tij pacifiste”. Vrasja e Franc Ferdinandit, thjesht i dha Austrisë justifikimin që i duhej.

Perandoria e Habsburgëve donte të zgjerohej në Ballkan, dhe Serbia ishte rivalja e saj më e madhe në rajon. Qeveria austriake, ishte në gjendje të shfrytëzonte një sulm të tmerrshëm nga një grup i vogël ekstremistësh për të justifikuar ambiciet e saj imperialiste, në emër të mbrojtjes nga terroristët.

Mjerisht, shumë gënjeshtra të tjera u thanë nga çdo komb. Kjo është natyra e propagandës, e cila arriti ekstreme të reja gjatë Luftës së Parë Botërore.

Britania, i mblodhi “baronët” e saj të mediave për të udhëhequr ministrinë e re të Informacionit. Përveç censurimit të lajmit të keq për dështimet ushtarake të Britanisë në frontin e luftës, ajo përhapi histori se gjermanët kryenin masakra, përdhunonin dhe gjymtonin gra dhe fëmijë.

Hetimet gjatë dhe pas luftës, nuk gjetën prova që t'i mbështesin këto pretendime. Kur një nëndetëse gjermane mbyti anijen “Lusitania” dhe vrau 1200 civilë, kjo u paraqit si një krim lufte.

Por SHBA-ja dhe Britania e fshehën faktin se ajo anije transportonte në fakt armatime, dhe Gjermania kishte paralajmëruar se ishte një objektiv i luftës.

Sikurse shkroi gazetari i luftës Filip Najtëll: “I gjithë aparati i shtetit, hyri në veprim për të shtypur të vërtetën”. Në vitin 1917, presidenti Udrou Uillson tha se Amerika duhej t'i bashkohej luftës, për t'i dhënë fund tiranisë, dhe për të ruajtur demokracinë. Në vitin 1919 ai tha: “A ka ndonjë fëmijë që nuk e di se fara e luftës në botën moderne, është rivaliteti industrial dhe tregtar? Kjo është një luftë industriale dhe komerciale”.

Kjo është arsyeja, se përse lufta u përshkallëzua aq shpejt. Perandoritë e ndryshme të përfshira në të, ishin kaq konkurruese, sa që do të shfrytëzonin çdo mundësi që u jepej për të rrëmbyer territorin, dhe për të dobësuar njëra-tjetrën.

Ata nuk prisnin që lufta t'i dobësonte të gjithë deri në atë përmasë, sa që do t'i hapte rrugën Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për t'u bërë fuqia hegjemone në botë – dhe të hidhnin themelet për një Luftë të Dytë Botërore. Edhe atëherë, lufta mund të ishte shmangur. Austro-Hungaria shpërfilli paralajmërimin për rrezikun që i kanosej Arkidukës në Sarajevë. Ajo fajësoi me dashje qeverinë serbe për veprimet e një grupi të fshehtë terrorist, vrasësi i të cilës ishte lindur në Perandorinë e tyre.

Ata manipuluan të vërtetën për të justifikuar luftën me rivalen e tyre. Të gjitha fuqitë kryesore, e fshehën të vërtetën, për të inkurajuar miliona njerëz të zakonshëm të luftonin dhe vdisnin. Fuqia shtytëse pas Luftës së Parë Botërore, ishte një seri e pafundme gënjeshtrash.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MBROJTJES

RRITJA E PAGAVE TË USHTARAKËVE

NËNTOGER / NËNLEJTËNANT



PAGA PËRFSHIN PAGËN BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FA